Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë - OMIK

UDHËZUES I SHKURTËR
PËR
VENDVOTIMET
NË KOSOVË

2002

Përgatitur nga Departamenti i Operacioneve të Zgjedhjeve i Misionit të OSBE-së në Kosovë

LETRA E MIRËSEARDHJES

Të nderuar zyrtarë të zgjedhjeve,

Mirë se vini në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) Misioni në Kosovë. Ne jemi shumë të kënaqur që keni vendosur të merrni pjesë në Zgjedhjet Komunale të Kosovës më 26 tetor të vitit 2002, që do të zhvillohen në qendrat e votimit në mbarë Kosovën, në Serbi dhe në Mal të Zi. Shpresojmë se këtë do ta konsideroni përvojë sfiduese dhe të dobishme.

Funksioni juaj do të jetë njëri nga më të rëndësishmit në Ditën e Zgjedhjeve, meqë prania juaj është hapi i parë për të siguruar që këto Zgjedhje Komunale të zhvillohen në përputhje me standardet ndërkombëtare. Përpjekjet tuaja do të jenë kontribut i rëndësishëm për qëllimin e përgjithshëm të ndërtimit të institucioneve demokratike për të mirën e gjithë njerëzve të Kosovës, qoftë të atyre që tani jetojnë në Kosovë, Serbi ose në Mal të Zi. Në punën tuaj drejt këtij synimi do t'ju bashkohen shumë anëtarë të tjerë të personelit, mbikëqyrës ndërkombëtarë të vendvotimeve dhe vëzhgues nga shumë vende dhe me përvoja të ndryshme.

Pa marrë parasysh se a jeni zyrtar i ri apo i rikthyer i zgjedhjeve, ju po arrini në kohë shumë ngazëllyese dhe të rëndësishme për Kosovën. Këto do të jenë zgjedhjet e treta të organizuara nga Misioni i OSBE-së në Kosovë. Zgjedhjet e para komunale janë mbajtur në tetor të vitit 2000, të cilat u pasuan nga zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, që u zhvilluan në nëntor të vitit 2001. Dy zgjedhjet e mëparshme janë vlerësuar si të drejta, legjitime dhe të vlefshme nga komuniteti ndërkombëtar, nga njerëzit dhe liderët politikë të Kosovës. Sivjet shpresojmë ta tejkalojmë nivelin e profesionalizmit dhe të transparencës të arritur në zgjedhjet e mëparshme. Si zyrtar profesional i zgjedhjeve, posti juaj është pjesë e qenësishme e kësaj përpjekjeje.

Dita e Zgjedhjeve është pjesa më e dukshme dhe e vështrueshme e çdo procesi të zgjedhjeve. Prania juaj do ta inkurajojë ndjenjën ndër të gjithë njerëzit e Kosovës se rregullat dhe rregulloret zbatohen në mënyrë të paanshme dhe transparente, duke ngritur kështu shkallën e besimit në rezultatet dhe në procesin demokratik në përgjithësi.

Ne e mirëpresim ngrohtësisht ardhjen tuaj në Misionin e OSBE-së dhe ju falënderojmë për kontributin tuaj për ndërtimin e nj02-09-24ë procesi gjithpërfshirës të zgjedhjeve në Kosovë.

Me respekt,

Ambasadori Pascal Fieschi
Kryesues i Misionit
Misioni i OSBE-së në Kosovë

Susan Carnduff
Drejtore e Operacioneve të Zgjedhjeve
Misioni i OSBE-së në Kosovë

TABLE OF CONTENTS

LETRA E MIRËSEARDHJES i

TABLE OF CONTENTS ii

I. OBLIGIMET TUAJA SI ZYRTAR I ZGJEDHJEVE I OSBE-SË 1
Mirësjelljet e rëndomta kur u ofrohet shërbim votuesve 1
Kodi i Mirësjelljes i zyrtarit të zgjedhjeve 1

II. PASQYRË E PËRGJITHSHME: PËRGJEGJËSITË E ZYRTARËVE TË ZGJEDHJEVE 5
Qendrat e votimit dhe vendvotimet 5
Udhëheqja e qendrës së votimit 5
Tavolinat ndihmëse 5
Rolet dhe përgjegjësitë në vendvotim 6
Përgjegjësitë e kryesuesit të këshillit të vendvotimit (KKV) 6
Përgjigjet ndaj shqetësimeve të vëzhguesve dhe votuesve 6

III. MATERIALET E ZGJEDHJEVE 7
Materialet e ndjeshme që përdoren për t'i procesuar votuesit në Ditën e Zgjedhjeve 7
Fletëvotimet 7
Lista përfundimtare e votuesve (LPV) 9
Lista përfundimtare e votuesve për tërë komunën 11
Materiali jo i ndjeshëm që përdoret për t'i procesuar votuesit në Ditën e Zgjedhjeve 11
Kutia e votimit 11
Kabinat e votimit 11
Libri i votimit 12
Formulari i përputhjes dhe rezultateve 12
Mjeti me ngjyrë dhe llamba ultravjollcë 14
Zarfat e fletëvotimeve me kusht dhe zarfat e fshehtësisë 14

IV. DETYRAT PARA DITËS SË ZGJEDHJEVE 15
Planifikimi paraprak i kryesuesit të KKV-së 15
Përgatitjet në vendvotim 15
Shpaketimi i materialeve jo të ndjeshme 15
Etiketoni, zarfat, thasët dhe formularët që përdoren në Ditën e Zgjedhjeve 15
Gjërat që duhet të kihen parasysh kur rregullohet vendvotimi 16
Vendosja e shenjave dhe njoftimeve 17
Organizoni simulimin e votimit dhe të numërimit 18

V. PËRGATITJET NË MËNGJES PARA ZGJEDHJEVE 19
Përgatitjet përfundimtare në vendvotim 19
Para se të votojë votuesi i parë 19

VI. ZHVILLIMI I VOTIMIT 21
Orët e votimit 21
Përcaktimi se kush mund të votojë 21
Votuesit me kusht 21
Votuesit me dëftesa të lëshuara përmes postës ose në Serbi, ose në Malin e Zi 22
Zotësia juridike për të votuar 22
Dëshmia e identitetit 22
Të dhënat mbi regjistrimin 24
Të dhëna mbi fletëvotimet me kusht 24
Bazat për refuzimin e personit për të votuar me fletëvotim të rregullt apo me kusht 25
Përmbledhje: Diagrami i vendimeve mbi zotësinë juridike të votuesit 25

Diagrami i vendimeve mbi zotësinë juridike të votuesit 26
Procesimi i votuesve 27
Rregulla të përgjithshme 27
Votuesit që kanë nevojë për ndihmë 27
Procesimi i votuesve të rregullt 27
Si të paloset fletëvotimi 32
Procesimi i votuesve me kusht 33
Udhëzime mbi zarfin e fletëvotimit me kusht 35

VII. PËRFUNDIMI I VOTIMIT DHE NUMËRIMI I FLETËVOTIMEVE 39
Përfundimi i votimit 39
Mbyllja e qendrës së votimit 39
Mbyllja e vendvotimeve në kuadër të qendrës së votimit 39
Përgatitja për numërim 39
Numërimi i fletëvotimeve në kutinë e votimit 40
Ndani të gjithë zarfat e fletëvotimeve me kusht nga fletëvotimet e tjera 40
Përcaktoni numrin e fletëvotimeve të rregullta 40
Numërimi i votave 41
Klasifikoni fletëvotimet e rregullta 41
Rregullat për të përcaktuar nëse fletëvotimi është i vlefshëm, i pavlefshëm apo i paplotësuar 41
Klasifikoni dhe numëroni fletëvotimet e vlefshme 48

VIII. PAKETIMI DHE TRANSPORTIMI 51
Detyrat përfundimtare 52
Pajisjet që duhet të lihen në qendrën e votimit 52
Pastrojeni vendvotimin dhe qendrën e votimit 52
Diagrami i paketimit 53

I. OBLIGIMET TUAJA SI ZYRTAR I ZGJEDHJEVE I OSBE-SË

Si mbikëqyrës ndërkombëtar i vendvotimit ose si anëtar i emëruar siç duhet i këshillit të vendvotimit, jeni njëri ndër ata pak zyrtarë të zgjedhjeve me të cilët shumica e votuesve do të kenë kontakt të drejtpërdrejtë gjatë rrjedhës së këtyre zgjedhjeve. Prandaj ka rëndësi shumë të madhe ta ruani nivelin më të lartë të sjelljes dhe të integritetit profesional gjatë përmbushjes së detyrave tuaja, duke u shërbyer votuesve të Kosovës. Kjo përfshin detyrat tuaja parazgjedhore, siç janë: vijimi i trajnimit, përgatitja dhe rregullimi i vendvotimit tuaj, si dhe përgjegjësitë tuaja në Ditën e Zgjedhjeve, gjatë numërimit të fletëvotimeve dhe raportimit të rezultateve të vendvotimit.

Ky zotim do të shkonte në të mirë të ndërtimit të nivelit të qëndrueshëm të besimit që votuesit dhe subjektet politike presin nga sistemi i tyre i zgjedhjeve. Ata do t'ju shikojnë, siç do t'ju shikojnë vëzhguesit dhe anëtarët e komunitetit ndërkombëtar që do t'i vëzhgojnë këto zgjedhje.

Objektivi ynë i përbashkët është të sigurojmë që sjellja, integriteti, neutraliteti dhe saktësia, së bashku, ta përballojnë vështrimin e publikut gjatë zhvillimit të këtyre zgjedhjeve.

Mirësjelljet e rëndomta kur u ofrohet shërbim votuesve

Gjithmonë ofrojuni shërbime me mirësjellje, përzemërsi, durim dhe dashamirësi, të gjithë votuesve, zyrtarëve të zgjedhjeve, vëzhguesve vendorë dhe ndërkombëtarë të procesit të zgjedhjeve.

Kur u ofroni shërbim votuesve të moshuar, analfabetëve ose atyre me pengesa fizike, ose atyre që kanë vështirësi në gjuhë ose në komunikim, kushtonu kohë të nevojshme që t'u shpjegoni procesin dhe drejtoni te personi i caktuar përgjegjës për t'u ndihmuar në secilën fazë.

Më mirë flisni drejtpërsëdrejti me personin me të meta, se sa t'i drejtoheni shoqëruesit të tij ose të saj. Mos bërtitni nëse votuesi nuk dëgjon mirë.

Kodi i Mirësjelljes i zyrtarit të zgjedhjeve

Në kohën e kontraktimit, të gjithë zyrtarët e zgjedhjeve nënshkruajnë KODIN E MIRËSJELLJES TË ZYRTARIT TË ZGJEDHJEVE. Origjinali i nënshkruar vendoset në dosjen e personelit të zyrtarit të zgjedhjeve. Ky kod reprodukohet në faqet vijuese për t'ia rikujtuar zyrtarit të zgjedhjeve zotimin ndaj dispozitave të këtij kodi.

KODI I MIRËSJELLJES I ZYRTARIT TË ZGJEDHJEVE

Si zyrtar i zgjedhjeve, pajtohem që t'u përmbahem dhe t'i respektoj parimet vijuese gjatë kryerjes së të gjitha detyrave në përputhje me Kodin e Mirësjelljes të paraqitur më poshtë.

Të gjithë zyrtarët e Ditës së Zgjedhjeve:

Rregullat dhe rregulloret

- do t'i respektojnë të gjitha rregulloret dhe direktivat administrative të aplikueshme të UNMIK-ut, të gjitha rregullat e zgjedhjeve të nxjerra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe të gjitha procedurat administrative të nxjerra nga Drejtorja e Departamentit të Operacioneve të Zgjedhjeve;

Me paanësi

- do të veprojnë në mënyrë jopartiake dhe të paanshme gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, do t'i shmangen çdo veprimi dhe çdo lloji të prononcimit publik që mund ta diskreditojë integritetin, pavarësinë dhe paanësinë e funksioneve të tyre si zyrtarë të zgjedhjeve;
- me asnjë veprim, qëndrim, shprehi ose fjalim nuk do të shfaqin përkrahje për asnjë subjekt politik, koalicion, iniciativë qytetare ose kandidat;
- nuk do të mbajnë as ekspozojnë veshje ose simbole që lidhen me politikë ose religjion, e as që do të ekspozojnë në çfarëdo mënyre gjësende të tjera që paraqesin ose sugjerojnë ndonjë mesazh politik, shoqëror ose religjioz;
- nuk do ta shfrytëzojnë pozitën e tyre si zyrtarë të zgjedhjeve për të ndikuar në votuesit në asnjë mënyrë, çfarëdoqoftë ajo, që ndonjë subjekt politik i caktuar të përfitojë në dëm të subjekteve politike të tjera. Sjellja e tillë ndalohet me nenin 4 të Rregullës së Zgjedhjeve nr. 1/2002 dhe i nënshtrohet sanksionit nga Nënkomisioni i Zgjedhjeve për Parashtresa dhe Ankesa në përputhje me nenin 5 të Rregullës së Zgjedhjeve nr. 6/2002;

Përfitimi personal

- nuk do të shfrytëzojnë, e as që do të përpiqen ta shfrytëzojnë pozitën e tyre për përfitime private dhe nuk do pranojnë dhurata, shpërblime ose përfitime personale, pa marrë parasysh qëllimin;

Diskrecioni dhe ruajtja e fshehtësisë

- do të respektojnë pa kusht marrëveshjen e besimit të nënshkruar para fillimit të punës;
- do të respektojnë fshehtësinë e votimit;
- do të sigurojnë që gjithë informacioni personal që ka të bëjë me votuesit të përdoret vetëm me qëllim të ofrimit të ndihmës ndaj votuesve për ta ushtruar të drejtën e tyre të votimit, dhe nuk do të kopjohet, reprodukohet ose t'i jepet asnjë individi, subjekti politik, koalicioni, iniciative qytetare ose kandidati;

Kryerja e detyrave

- do të sigurojnë që përgjegjësitë e marra përsipër dhe puna e kryer të bëhen me saktësi dhe me zell;
- do të sillen në mënyrë të atillë që nderohet dhe respektohet nga të gjithë, pa marrë parasysh gjininë, religjionin ose besimin, prejardhjen etnike ose shoqërore, moshën, ose ndonjë aspekt tjetër të statusit personal;
- nuk do të angazhohen në asnjë aktivitet ose sjellje që nuk përputhet me kryerjen siç duhet të detyrave të tyre;

- do t'i vijojnë të gjitha sesionet e trajnimit dhe do të njihen me të gjitha procedurat relevante të Ditës së Zgjedhjeve që sigurohen nga OSBE-ja para fillimit të detyrave;

Shfrytëzimi i pronës së OSBE-së

- do të tregojnë kujdes të nevojshëm kur i shfrytëzojnë mjetet dhe pronën e OSBE-së. Zyrtarët e zgjedhjeve do të japin llogari për çdo lënie pas dore, humbje ose dëm të shkaktuar ndaj mjeteve dhe pronës së tillë, qoftë qëllimisht ose për shkak të pakujdesisë.

E kuptoj se prej meje pritet t'u përmbahem standardeve të sjelljes të përcaktuara këtu, dhe se çdo shkelje e kushteve me të cilat pajtohem paraqet bazë për përjashtim të menjëhershëm nga puna, kurse shkelja e ligjit ose e rregullës së zgjedhjeve mund të ketë për pasojë paraqitjen para autoriteteve përkatëse për ndjekje.

Jam plotësisht i vetëdijshëm se obligimet që kanë të bëjnë me ruajtjen e fshehtësisë nuk përfundojnë me kryerjen e detyrave të mia në zgjedhje ose me përfundimin, për çfarëdo arsye, të shërbimit tim si zyrtar i zgjedhjeve.

Me këtë deklaroj se e kam lexuar dhe kuptuar plotësisht këtë që thuhet më lartë, dhe se do t'i përmbahem këtij Kodi të Mirësjelljes gjatë kryerjes së të gjitha detyrave të mia.

Nënshkruar në _____ më _____2002.

_____

Emri i zyrtarit të zgjedhjeve

_____

Nënshkrimi i zyrtarit të zgjedhjeve

II. PASQYRË E PËRGJITHSHME: PËRGJEGJËSITË E ZYRTARËVE TË ZGJEDHJEVE

Në këtë kapitull përshkruhen organizimi dhe udhëheqja e qendrave të votimit dhe e vendvotimeve, rolet dhe përgjegjësitë e mbikëqyrësve ndërkombëtarë të vendvotimeve dhe të të gjithë zyrtarëve të zgjedhjeve.

Qendrat e votimit dhe vendvotimet

Qendra e votimit është godinë ose strukturë ku mund të vendosen prej një deri në 14 **vendvotime**. Qendra e votimit përfshin edhe hapësirën brenda 25 metrash nga hyrja e godinës. Në shumicën e rasteve godinat që përdoren si qendra të votimit janë shkollat ose objektet e bashkësisë.

Vendvotimi është një hapësirë e caktuar brenda **qendrës së votimit** ku do të zhvillohet votimi. Zakonisht ato janë klasë të shkollave.

Në Kosovë ka rreth 550 qendra të votimit që përmbajnë mbi 1700 vendvotime. Në Mal të Zi dhe në Serbi janë 100 qendra të votimit që përmbajnë rreth 250 vendvotime.

Në Kosovë, për çdo vendvotim caktohen rreth 750 votues. Në Serbi dhe në Mal të Zi, për çdo vendvotim caktohen rreth 500 votues.

Udhëheqja e qendrës së votimit

Menaxheri i qendrës së votimit është përgjegjës për organizimin dhe planifikimin e të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me objektin—qendrën e votimit—që është jashtë vendvotimit.

Aktivitetet e vendvotimit janë nën përgjegjësinë e **kryesuesit të këshillit të vendvotimit (KKV)** dhe të mbikëqyrësit ndërkombëtar të vendvotimit **(MNV).**

Për të siguruar që votuesve të veçantë dhe turmës së madhe t'u shërbehet në mënyrë efikase dhe të mbahet rendi gjatë tërë kohës, janë bërë disa përgatitje për të siguruar personel udhëheqës shtesë të qendrës së votimit, për të gjitha qendrat e votimit.

Numri i personelit udhëheqës që caktohet në qendër të votimit do të varet nga numri i vendvotimeve të vendosura në kuadër të lokacionit të njëjtë.

Tavolinat ndihmëse

Në qendra të votimit do të caktohen dhe njerëz shtesë për t'i ndihmuar votuesit që janë paraqitur në qendrën jo të saktë të votimit, të cilët mund të mos jenë në Listën përfundimtare të votuesve dhe në disa raste të mos kenë dokumentin e duhur të identifikimit.

Në shumicën e rasteve, votuesit përcillen te tavolina ndihmëse, nëse nuk kanë dokument të duhur të identifikimit ose të regjistrimit. Poashtu votuesit mund të kenë nevojë të drejtohen sërish në qendrën e tyre të votimit ku janë caktuar.

Nëpër qendra të votimit do të caktohet një numër i personelit të tavolinës ndihmëse varësisht nga numri i vendvotimeve në kuadër të qendrës

Rolet dhe përgjegjësitë në vendvotim

Përgjegjësitë e kryesuesit të këshillit të vendvotimit (KKV)

I udhëzuar dhe i ndihmuar për mbikëqyrje nga mbikëqyrësi ndërkombëtar i vendvotimit, kryesuesi i këshillit të vendvotimit është përgjegjës për funksionimin e përgjithshëm të vendvotimit. Përpos detyrave operative në Ditën e Zgjedhjeve, kryesuesi i këshillit të vendvotimit ka edhe detyra të tjera të paraqitura në rregullat e zgjedhjeve dhe procedurat administrative të nxjerra nga Drejtori i Operacioneve të Zgjedhjeve.

Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit Ndërkombëtar të Vendvotimeve(MNV)

Me ndihmën mbikëqyrëse dhënë Kryesuesit të Këshillit të vëndvotimit(KKV), MNV-ja mbikëqyr procedurat e zhvillimit të votimit dhe numërimit në vendvotim në përpuethshmëri me Procedurat Administrative të Zgjedhjeve Komunale në Kosovë 2002.

Ndihma e trajnerit

Gjatë votimit dhe numërimit, juve ju ndihmojnë trajnerët. Trajnerët vendorë dhe ndërkombëtarë bëjnë vizita të rregullta nëpër vendvotime. Nëse keni ndonjë pyetje, pyetni. Nëse ka probleme serioze, trajneri që flet gjuhën përkatëse mund të caktohet në vendvotim për aq kohë sa të jetë e nevojshme.

Përgjigjet ndaj shqetësimeve të vëzhguesve dhe votuesve

Trajtoni me mirësjellje vëzhguesit e procesit të zgjedhjeve dhe votuesit dhe përgjigjuni në pyetjet e tyre menjëherë dhe saktësisht.

Vëzhguesit e procesit të zgjedhjeve dhe votuesit duhet t'i paraqesin pyetjet dhe problemet e tyre te kryesuesi i këshillit të vendvotimit ose te mbikëqyrësi ndërkombëtar i vendvotimit.



III. MATERIALET E ZGJEDHJEVE

Në këtë kapitull përshkruhen materialet që përdoren gjatë rrjedhës së zgjedhjeve. Në kapitujt vijues përshkruhen detyrat dhe procedurat që kanë të bëjnë me pranimin dhe përdorimin e këtyre materialeve.

Materialet e ndjeshme që përdoren për t'i procesuar votuesit në Ditën e Zgjedhjeve

Artikujt e mëposhtëm janë shumë të rëndësishëm për procesimin e votuesve, numërim dhe raportimin e rezultateve. Për mungesën e ndonjërit prej këtyre artikujve duhet t'i raportohet menjëherë personit për kontaktim të OSBE-së.

Fletëvotimet

- Secila prej 30 komunave në Kosovë do të ketë fletëvotimin e veçantë. Emrat e të gjitha subjekteve politike që kanë përmbushur kushtet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vërtetim do të shtypen në gjuhën e përcaktuar nga subjekti politik.

- Në informatën e shtypur në ballinën e fletëvotimit përfshihen emri dhe numri i komunës, udhëzimet si të shënohen fletëvotimet dhe emrat e subjekteve. Udhëzimet si të shënohen fletëvotimet shkruhen në gjuhën shqipe, serbe dhe turke, në krye të ballinës së fletëvotimit. Numri i komunës shtypet në shpinë të fletëvotimit.

- Fletëvotimet janë të ngjitura në blloqe me nga 50 copë. Nga katër blloqe janë të paketuara së bashku, duke e formuar një pako të fletëvotimeve (me 200 fletëvotime) të mbështjellë me plastikë të tejdukshme. Një vendvotim i merr pesë pako me fletëvotime me gjithsej1000 fletëvotime, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga zyra e OSBE-së.

- Ama e bllokut të fletëvotimeve është pjesa e vogël e fletëvotimit mbi vendin e vrimëzuar. Kapëset shkojnë mbi blloqet amë. Në çdo amë të bllokut të fletëvotimeve është i shtypur numri serik i veçantë. Ky numër serik është në kuadër të vargut të numrave serikë të caktuar të vendvotimit. Numrat serikë mundësojnë që çdo fletëvotim që i jepet vendvotimit të numërohet dhe të regjistrohet në Formularin e përputhjes dhe rezultateve.

- Nën amën e bllokut është vija e vrimëzuar ku shkëputet fletëvotimi kur i jepet votuesit. Në vetë fletëvotimin nuk ka numër serik ose ndonjë identifikues tjetër. Pasi të jetë përdorur blloku me 50 fletëvotime, të 50 amat e blloqeve të fletëvotimeve mbesin të ngjitura së bashku. M**os i hiqni fare kapëset.**

- Pakot e fletëvotimeve duhet të hapen njëra pas tjetrës. Kryesuesi i këshilit të vendvotimit duhet t'i sigurojë pakot e pahapura të fletëvotimeve, derisa dhënësi i fletëvotimeve të kërkojë grupin tjetër. Fletëvotimet duhet të përdoren sipas rendit të numrit serik, duke filluar nga fletëvotimi që gjendet në fillim të bllokut. Kjo e lehtëson përputhjen pasi të përfundojë votimi.


Numri serik i fletëvotimit
Serijski broj glasačkog listića
Ballot Serial Number
02 001234
Ama e bllokut të fletëvotimeve
Odsečak
Stub
Vrimëzimi
Izbušene rupice
Perforation
OSCE
Mission in Kosovo
CEC
UNMIK
ZGJEDHJET KOMUNALE 2002
OPŠTINSKI IZBORI 2002.
ОПШТИНСКИ ИЗБОРИ 2002.
2002 BELEDİYE SEÇİMLERİ
XX. XXXXXXXX / XXXXXXX
ZGJEDHNI VETËM NJË SUBJEKT POLITIK NGA LISTA DHE SHËNONI ZGJEDHJEN TUAJ NË KATRORIN PARA EMRIT TË SUBJEKTIT POLITIK.
ОДАБЕРИТЕ САМО ЈЕДАН ПОЛИТИЧКИ СУБЈЕКАТ СА ЛИСТЕ И НАЗНАЧИТЕ ВАШ ИЗБОР У КВАДРАТИЋУ ИСПРЕД ИМЕНА ПОЛИТИЧКОГ СУБЈЕКТА.
ODABERITE SAMO JEDAN POLITIČKI SUBJEKAT SA LISTE I NAZNAČITE VAŠ IZBOR U KVADRATIĆU ISPRED IMENA POLITIČKOG SUBJEKTA.
LİSTEDEN SADECE BİR POLİTİK OLUŞUMU SEÇİNİZ VE TERCİHİNİZİ POLİTİK OLUŞUMUN ADININ ÖNÜNDEKİ KAREYE İŞARETLEYİNİZ.
00. XX - XXXXX X XXXXXXXXX
00. XXXXX - XXXXX X XX X XXXXXX
00. XXX - XXXXX XXXXXXX X XXXXXXXX
00. XXXX - XXXXX X XX XXXXXXXX XX XXXXXXXX
Udhëzimet për shënimin e fletëvotimit:
Uputstva za obeležavanje glasačkog listića:
Instructions for marking ballot:
CHOOSE ONLY ONE POLITICAL ENTITY FROM THE LIST AND MARK YOUR CHOICE IN THE BOX IN FRONT OF THE NAME OF THE POLITICAL ENTITY.
Subjektet për komunën
(Sipas rendit të përcaktuar gjatë tërheqjes së shortit për fletëvotim)
Politički subjekti za opštinu
(Po redosledu utvrđenom tokom žrebanja za redosled na glasačkom listiću)
Entities for Municipality
(In the order dertermined during the Ballot Lottery)

Lista përfundimtare e votuesve (LPV)

- Çdo vendvotim ka Listë përfundimtare të votuesve, në të cilën përfshihen emrat e të gjithë votuesve të caktuar për të votuar në atë vendvotim. Ky dokument i ndjeshëm përdoret për të ndihmuar për identifikimin e votuesve dhe dëshmimin e zotësisë juridike të tyre për ta hedhur votën. Çdo votues nënshkruan në Listën përfundimtare të votuesve, si vërtetim se ai/ajo e ka marrë fletëvotimin.

- Emrat në Listën përfundimtare të votuesve radhiten sipas mbiemrit, të radhitur sipas rendit alfabetik. Duke përdorur alfabetin latin si bazë për përgatitjen e Listës përfundimtare të votuesve, rendi alfabetik i merr në konsiderim shkronjat e veçanta që ekzistojnë në gjuhët që fliten në Kosovë, ku përfshihet gjuha shqipe, serbe dhe turke. Për t'u referuar më lehtë, ky alfabet i konsoliduar është shtypur në LPV.

- Lista për çdo votues përmban fotografinë, emrin dhe mbiemrin, datën e lindjes numrin e regjistrimit dhe barkodin që mund të skanohet. Aty ka hapësirë edhe për nënshkrimin e votuesit. Në një numër të vogël rastesh nuk ka fotografi.

- Në LPV–në e çdo vendvotimi në kuadër të qendrës së votimit përfshihen vetëm votuesit që janë në kuadër të një radhe të caktuar alfabetike. Alfabeti ndahet për të siguruar e vendvotimet brenda qendrës të kenë numër relativisht të barabartë të votuesve për t'u shërbyer. Bëhet përpjekje që anëtarët e familjes me mbiemër të njëjtë të caktohen për të votuar në vendvotimin e njëjtë.

- Çdo faqe e Listës përfundimtare të votuesve ka të radhitur nga 20 votues dhe çdo listë ka rreth 40 faqe. **Lista përfundimtare e votuesve** së bashku me **Listën e votuesve me kusht** dhe **Listën e korrigjimeve** janë të lidhura në një mbështjellës të plastikës që është i tejdukshëm në pjesën e përparme, ndërkaq me ngjyrë të ndritshme në atë të prapme.

- Gjatë kohës më kulminante të aktivitetit, Lista përfundimtare e votuesve mund të ndahet, në mënyrë që njëkohësisht të procesohet më shumë se një votues.

Faqe nga Lista përfundimtare e votuesve:

Page Header
Municipality name and number

1101b/02r

AAAAAA BBBBBB 15.03.1975 291300125 Bar Code	AAAAAA BBBBBB 15.03.1976 291300126 Bar Code
AAAAAA CCCCCC 15.03.1980 291301125 Bar Code	AAAAAA BBBBBB 15.03.1976 291300129 Bar Code
AAAAAA BBBBBB 15.03.1975 291300130 Bar Code	AAAAAA BBBBBB 15.03.1976 291300131 Bar Code
AAAAAA CCCCCC 15.03.1980 291301132 Bar Code	AAAAAA BBBBBB 15.03.1976 291300133 Bar Code
AAAAAA BBBBBB 15.03.1975 291300134 Bar Code	AAAAAA BBBBBB 15.03.1976 291300150 Bar Code
AAAAAA CCCCCC 15.03.1980 291301151 Bar Code	AAAAAA BBBBBB 15.03.1976 291300158 Bar Code
AAAAAA BBBBBB 15.03.1975 291300125 Bar Code	AAAAAA BBBBBB 15.03.1976 291300126 Bar Code
AAAAAA CCCCCC 15.03.1980 291301160 Bar Code	AAAAAA BBBBBB 15.03.1976 291300161 Bar Code
AAAAAA BBBBBB 15.03.1975 291300178 Bar Code	AAAAAA BBBBBB 15.03.1976 291300199 Bar Code
AAAAAA CCCCCC 15.03.1980 291301177 Bar Code	AAAAAA BBBBBB 15.03.1976 291300100 Bar Code

x/y

Lista përfundimtare e votuesve për tërë komunën

Kjo është lista që i jepet çdo tavoline ndihmëse, në të cilën janë të radhitur të gjithë votuesit që gjenden në Listat përfundimtare të votuesve në kuadër të komunës. Nuk përmban fotografi, por në të tregohet nëse ka fotografi në LPV–në e vendvotimit.

Vula zyrtare e fletëvotimit

Vula zyrtare e fletëvotimit është njëra ndër materialet e ndjeshme të zgjedhjeve që krahas fletëvotimeve do t'i dorëzohet mbikëqyrësit ndërkombëtar të vendvotimit në Ditën e Zgjedhjeve.

Dy tampona me ngjyrë të **kaltër** që do të përdoren për vulën zyrtare të fletëvotimit do të përfshihen në kompletin e pajimeve të vendvotimit, që përmban materiale jo të ndjeshme dhe MNV-ja i jep KKV-së një ditë para zgjedhjeve.

Materiali jo i ndjeshëm që përdoret për t'i procesuar votuesit në Ditën e Zgjedhjeve

Kutia e votimit

Çdo vendvotim do ta ketë nga një kuti të votimit që është prodhuar nga plastika e fortë gjysëmtransparente.

Kapaku i përhimtë i kutisë së votimit ka një vrimë përmes së cilës çdo votues duhet ta vendosë fletëvotimin e shënuar. Kjo vrimë e ka kapakun e rrëshqitshëm që duhet të mbyllet pasi të shpallet vendvotimi i mbyllur.

Kabinat e votimit

Çdo vendvotim do të pajiset me nga katër kabina të votimit për t'u mundësuar votuesve që t'i shënojnë fletëvotimet e tyre në fshehtësi.

Libri i votimit

- Libri i votimit, i paketuar në çdo kuti të pajimeve të vendvotimit, përdoret për të regjistruar punën e zakonshme dhe ngjarjet ose rrethanat me rëndësi.

Në libër të votimit do të kenë qasje edhe individët tjerë, që janë të autorizuar të jenë të pranishëm në vendvotim, përfshirë edhe votuesit që dëshirojnë t'i regjistrojnë vërejtjet, problemet ose komentet e tyre.

Formulari i përputhjes dhe rezultateve

Formulari i përputhjes dhe rezultateve është dokument që përdoret për përputhjen e numrit të gjithmbarshëm të fletëvotimeve që i janë dhënë vendvotimit dhe për raportimin e rezultateve të subjekteve në atë vendvotim. Formulari i përputhjes dhe rezultateve e plotëson KKV-ja me ndihmën e MNV-së.



OSCE Mission in Kosovo — OBRAZAC ZA USKLAĐIVANJE I REZULTATE / RECONCILIATION AND RESULTS FORM — FORMULARI I PËRPUTHJES DHE REZULTATEVE — CEC — QENDRA E NUMËRIMIT DHE REZULTATEVE / CENTAR ZA PREBROJAVANJE I REZULTATE / COUNTING AND RESULTS CENTRE — UNMIK

00. XXXXX / XXXXX

PJESA I - ODELJAK I - SECTION I: PARA HAPJES - PRE OTVARANJA - BEFORE OPENING

1. Numri i vendvotimit / Broj biračkog mesta / Polling Station number — 0 0 / r
2. Numrat e shiritave që përdoren për mbylljen e kapakut të kutisë së votimit / Brojevi zaštitnih pečata upotrebljenih za zatvaranje poklopca glasačke kutije / Seal numbers used for sealing Ballot Box Cover

PJESA II - ODELJAK II - SECTION II: PARA DHE GJATË VOTIMIT - PRE I TOKOM GLASANJA - BEFORE AND DURING VOTING

3. Numri i fletëvotimeve të pranuara / Broj primljenih glasačkih listića / Number of ballots received — Prej/Od/From — Deri/Do/To
4. Numri i fletëvotimeve plotësuese të pranuara / Broj dodatnih primljenih glasačkih listića / Number of additional ballots received (+) — Prej/Od/From — Deri/Do/To
5. Numri i fletëvotimeve të transferuara / Broj prenesenih glasačkih listića / Number of ballots transferred (−) — Prej/Od/From — Deri/Do/To
6. Numri i rishikuar i fletëvotimeve / Novo brojčano stanje glasačkih listića / Revised number of ballots (=)

PJESA III - ODELJAK III - SECTION III: PAS MBYLLJES SË VENDVOTIMIT - POSLE ZATVARANJA BIRAČKOG MESTA / AFTER CLOSING THE POLLING STATION

7. Numri i shiritit që përdoret për mbylljen e vrimës së kutisë së votimit / Broj zaštitnog pečata upotrebljenog za zatvaranje proreza na glasačkoj kutiji / Seal number used for sealing Voting Slot
8. Numri i fletëvotimeve të paperdorura / Broj neupotrebljenih glasačkih listića / Number of Unused Ballots
9. Numri i fletëvotimeve të prishura / Broj neispravnih glasačkih listića / Number of Spoiled Ballots (+)
10. Numri i nënshkrimeve në listën përfundimtare të votuesve / Broj potpisa na konačnom biračkom spisku / Number of Signatures on Final Voters' List (+)
11. Numri i nënshkrimeve në listën e votuesve me kusht / Broj potpisa na uslovnom biračkom spisku / Number of Signatures on Conditional Voters' List (+)
12. Gjithsej: (8 + 9 + 10 + 11) / Ukupno (8 + 9 + 10 + 11) / Total (8 + 9 + 10 + 11) (=)

PJESA IV - ODELJAK IV - SECTION IV: PAS HAPJES SË KUTISË SË VOTIMIT - NAKON OTVARANJA BIRAČKE KUTIJE - AFTER OPENING THE BALLOT BOX

13. Numri i zarfeve me fletëvotime me kusht në kutinë e votimit / Broj koverti sa uslovnim glasačkim listićima u glasačkoj kutiji / Number of Conditional Ballot Envelopes in the Ballot Box
14. Numri i fletëvotimeve të regulta në kutinë e votimit / Broj redovnih glasačkih listića u glasačkoj kutiji / Number of Regular Ballots in the Ballot Box

Polling Station Committee Chairperson — Anëtar i këshillit të vendvotimit / Član komisije biračkog mesta — Polling Station Committee Member

PJESA V - ODELJAK V - SECTION V: PAS KLASIFIKIMIT TË FLETËVOTIMEVE TË RREGULLTA - NAKON SORTIRANJA REDOVNIH GLASAČKIH LISTIĆA - AFTER SORTING REGULAR BALLOTS

00. XXXXX - XXXXX x XX x XXXXXXXX
00. XXX - XXXXXX XXXXXXXXXXX X XXXXXXX
00. XXX - XXXXXX XXX XXXXXXXXXXXX X XXXXXXX
00. XXX - XXXXX XXXXXX X XXXX
00. XXXXX - XXXXX X XX X XXXXXXXX
00. XXX - XXXXXX XXXXXXXXXXX X XXXXXXX
00. XXX - XXXXXX XXX XXXXXXXXXXXX X XXXXXXX
00. XXX - XXXXX XXXXXX X XXXX

Vota të vlefshme / Važeći glasovi / Valid Votes

15. Gjithsej vota të vlefshme / Ukupan broj važećih glasova / Total Valid Votes

16. Fletëvotime të papërdorura / Nepopunjeni glasački listići / Blank Ballots
17. Fletëvotime të pavlefshme / Nevažeći glasački listići / Invalid Ballots (+)
18. Gjithsej fletëvotime të vlefshme (rubrika 15) / Ukupan broj važećih glasačkih listića (kvadratić 15) / Total Valid Ballots (Box 15) (+)
19. Gjithsej (16 + 17 + 18) / Ukupno (16 + 17 + 18) / Total (16 + 17 + 18) (=)

PJESA VII - ODELJAK VII - SECTION VII: REGJISTRIMI I SHIRITAVE MBYLLËS TË SIGURISË / ZABELEŽITI BROJEVE SIGURNOSNIH PEČATA / RECORD OF SECURITY SEALS

Numri i shiritit mbyllës të pakos 2. / Broj zaštitnog pečata za paket 2. / Seal number for Packet 2.
Numri i shiritit mbyllës të pakos 4. / Broj zaštitnog pečata za paket 4. / Seal number for Packet 4.
Numri i shiritit mbyllës të pakos 6. / Broj zaštitnog pečata za paket 6. / Seal number for Packet 6.
Numrat e shiritit mbyllës të kapakut të kutisë së votimit. / Brojevi zaštitnih pečata za poklopac glasačke kutije. / Seal numbers for Ballot Box Cover.
Numrat e ri të shiritave mbyllës, nëse kërkohet / Novi brojevi pečata ukoliko su isti neophodni / New seal numbers if required
Numri i shiritit mbyllës të pakos 2. / Broj zaštitnog pečata za paket 2. / Seal number for Packet 2.
Numri i shiritit mbyllës të pakos 4. / Broj zaštitnog pečata za paket 4. / Seal number for Packet 4.
Numri i shiritit mbyllës të pakos 6. / Broj zaštitnog pečata za paket 6. / Seal number for Packet 6.
Numrat e shiritit mbyllës të kapakut të kutisë së votimit. / Brojevi zaštitnih pečata za poklopac glasačke kutije. / Seal numbers for Ballot Box Cover.

PJESA VI - ODELJAK VI - SECTION VI

Përputhja /Usaglašavanje /Reconciliation:
A është rubrika 6 baraz me rubrikën 12? / Da li je kvadratić 6 jednak kvadratiću 12? / Does Box 6 equal Box 12?
Nëse jo, cili është dallimi? / Ukoliko nije, kolika je razlika? / If not, what is the difference?
A është rubrika 14 baraz me rubrikën 19? / Da li je kvadratić 14 jednak kvadratiću 19? / Does Box 14 equal Box 19?
Nëse jo, cili është dallimi? / Ukoliko nije, kolika je razlika? / If not, what is the difference?

Kryesuesi i këshillit të vendvotimit / Predsedavajući komisije biračkog mesta — Polling Station Committee Chairperson — Mëkëqyrësi ndërkombëtar i vendvotimit / Međunarodni nadzornik na biračkom mestu — International Polling Station Supervisor

Duke u nënshkruar më poshtë, vërtetoj se këto shifra pasqyrojnë me saktësi punën e numërimit në këtë vendvotim. / Potpisujući se ispod, ja tvrdim da ove cifre tačno odražavaju aktivnost prebrojavanja na ovom biračkom mestu. / By signing below, I attest that these figures accurately reflect the counting activity at this Polling Station.

Kryesuesi i këshillit të vendvotimit / Predsedavajući komisije biračkog mesta — Polling Station Committee Chairperson
Anëtar i këshillit të vendvotimit / Član komisije biračkog mesta — Polling Station Committee Member
Anëtar i këshillit të vendvotimit / Član komisije biračkog mesta — Polling Station Committee Member
Anëtar i këshillit të vendvotimit / Član komisije biračkog mesta — Polling Station Committee Member

DEO-02-412/xx

Mjeti me ngjyrë dhe llamba ultravjollcë

Çdo vendvotim do t'i ketë nga dy llamba ultravjollcë dhe katër mjete për spërkatje me ngjyrë të padukshme. Këto janë veçori të shtuara të sigurisë, për të siguruar që votuesi të mund të votojë vetëm një herë. Ngjyra e padukshme mund të shihet vetëm nën dritën ultravjollcë dhe ky mjet duhet të testohet nga KKV-ja para Ditës së Zgjedhjeve

Dhënësi i fletëvotimeve ia spërkat gishtin e djathtë tregues çdo votuesi që merr fletëvotimin. Sapo secili votues të hyjë në vendvotim, kontrollori i rreshtit e ndez dritën ultravjollcë, duke kaluar mbi të gjithë gishtërinjtë e votuesit, për të kontrolluar nëse duket ngjyra që tregon se votuesi tashmë ka votuar, dhe se ai votues nuk duhet të lejohet të votojë sërish.

Kontrrollimin e bën kontrollori i rreshtit:

Spërkatjen e bën dhënësi i fletëvotimeve:

Zarfat e fletëvotimeve me kusht dhe zarfat e fshehtësisë

Çdo vendvotim pajiset me nga 200 zarfa të fletëvotimeve me kusht dhe me po aq zarfa të kaltër të fshehtësisë.

Kur votuesi voton me fletëvotim me kusht, fletëvotimi vendoset brenda zarfit të kaltër të fshehtësisë, e cila pastaj mbyllet brenda zarfit të plotësuar të fletëvotimit me kusht, para se të vendoset në kutinë e votimit.

Shiritat mbyllës të sigurisë

Çdo kuti e pajimeve të vendvotimit do të ketë nga pesëmbëdhjetë shirita të shkurtër dhe po aq shirita të gjatë të sigurisë. Këta shirita janë rripa plastikë që mbërthehen dhe kur të mbërthehen nuk mund të çlirohen, veç nëse priten. Ata që janë më të shkurtër duhet të përdoren për kutinë e votimit, ndërsa më të gjatët për mbylljen e thasëve plastikë për transport. Çdo shirit ka numër të veçantë serik që shënohet në formularin e përputhjes dhe të rezultateve në fillim të votimit dhe në përfundim të procedurave të numërimit në fund të Ditës së Zgjedhjeve. Ky shënim siguron që kutia e votimit të mbetet e mbyllur pasi që KKV-ja t'i ketë përfunduar detyrat e veta në fund të numërimit.



IV. DETYRAT PARA DITËS SË ZGJEDHJEVE

Ekzistojnë disa detyra përgatitore që duhet të kryhen nga MNV-ja dhe KKV-ja, si dhe nga anëtarët e tjerë të këshillit të vendvotimit para zgjedhjeve. Në këtë kapitull përshkruhen ato aktivitete dhe përgjegjësi.

Planifikimi paraprak i kryesuesit të KKV-së

Kryesuesi i këshillit të vendvotimit është përgjegjës për funksionimin e tërësishëm të vendvotimit. Në mënyrë që detyrat e shumta të tij/saj të përmbushen në mënyrë të suksesshme, detyrat e caktuara duhet të përmbushen dukshëm para Ditës së Zgjedhjeve. Vetëm pasi të përmbushen këto përgjegjësi dhe pasi anëtarët e këshillit të jenë trajnuar si duhet, mund të pritet që procedurat e Ditës së Zgjedhjeve të rrjedhin me lehtësi dhe që çdo votues të mund të procesohet shpejt.

Përgatitjet në vendvotim

Të gjithë anëtarët e këshillit të vendvotimit, së bashku me mbikëqyrësin ndërkombëtar të vendvotimit, janë përgjegjës për rregullimin e vendvotimit.

Kjo detyrë duhet të përfundojë një ditë para zgjedhjeve. Çdo rregullim i ri i dhomës që mund të jetë i domosdoshëm para se të fillojë votimi, nuk duhet ta shtyjë hapjen e vendvotimit në orën 07.00 të Ditës së Zgjedhjeve.

Personeli udhëheqës i qendrës së votimit është përgjegjës për organizimin e vendosjes së qendrave të votimit.

Shpaketimi i materialeve jo të ndjeshme

Tani është koha të shpaketohet kutia e votimit që përmban materiale dhe artikuj të imtë të rëndësishëm për zgjedhjet. Lista për kontrollimin e materialeve vjen me kutinë e votimit. Artikujt kontrollohen duke i nxjerrë një nga një dhe duke i shënuar në listë.

Të gjitha llambat dhe bateritë duhet të nxirren nga kutia për ruajtje dhe duhet të testohen. Mos pritni deri në Ditën e Zgjedhjeve! Për çdo pajim që mungon duhet t'i raportohet menjëherë personit për kontaktim të OSBE-së, në mënyrë që të mund të furnizoheni sërish para fillimit të votimit.

Etiketoni, zarfat, thasët dhe formularët që përdoren në Ditën e Zgjedhjeve

Nga furnizimi juaj me materiale jo të ndjeshme, ndani të gjithë thasët dhe zarfat që ju nevojiten në Ditën e Zgjedhjeve. Shënoni emrin e komunës dhe numrin e vendvotimit në të gjithë formularët, etiketat dhe pakot që përdoren gjatë tërë Ditës së Zgjedhjeve. Mirëpo, mos nënshkruani në Formularin e përputhjes dhe rezulateve ose në ndonjë formular tjetër, ku kërkohen nënshkrime **pas** përfundimit të votimit.

Gjërat që duhet të kihen parasysh kur rregullohet vendvotimi

Vendvotimi duhet të organizohet që të mundësojë qarkullim sa më efikase të votuesve gjatë tërë ditës:.

- Ulëset duhet të rregullohen në atë mënyrë që anëtarët e këshillit të vendvotimit, mbikëqyrësi ndërkombëtar i vendvotimit dhe vëzhguesit e procesit të zgjedhjeve të mund ta shikojnë tërë procesin e votimit dhe ta shohin qartë kutinë e votimit gjatë gjithë kohës.
- Tavolinën e parë vendoseni në brendësi sa të mos bllokohet dera.
- Tavolinat e ndryshme vendosni në ato pozita që votuesit të mund të lëvizin sipas një rendi logjik nga njëra tavolinë te tjetra, pa u ndeshur me votuesit që hyjnë në vendvotim.
- Kurdo që ka mundësi, lini hapësirë të mjaftueshme midis tavolinave, kabinave të votimit, kutisë së votimit dhe karrigeve, në mënyrë që votuesit me pengesa për lëvizje të mund të kalojnë lehtë.
- Vendosni tavolinat në atë mënyrë që anëtarët e këshillit të vendvotimit të mund t'i shohin votuesit duke hyrë në vendvotim

Mënyra si e organizoni vendvotimin varet nga madhësia dhe trajta e dhomës, lokacioni i dyerve në hyrje dhe dalje, si dhe nga tavolinat, karriget ose bankat që janë aty. Provoni konfiguracione të ndryshme derisa ta gjeni ndonjë që funksionon. Kur jeni të kënaqur me atë rregullim, atëherë mund të përdorni shigjeta për orientim dhe/ose shiritin e OSBE-së në dysheme, për ta treguar drejtimin kah duhet të lëvizin votuesit prej kontrollorit të rreshtit te zyrtari i identifikimit, pastaj te dhënësi i fletëvotimeve, e kështu me radhë.

Diagrami në vijim ilustron një model të mundshëm të rregullimit të vendvotimit.



1. **Kontrollori i rreshtit** e kufizon hyrjen e votuesve, në mënyrë që të mos krijohet turmë njerëzish në vendvotim. Mund të paraqiten probleme kur njerëzit grumbullohen rreth kutisë së votimit ose tavolinave të punës, ndërsa anëtarët e këshillit dhe MNV-të nuk mund ta ndjekin mbarëvajtjen e rregullt të votuesve nga njëra tavolinë pune në tjetrën. Poashtu kontrollori i rreshtit duhet të sigurojë që njerëzit të largohen nga vendvotimi, sapo ta përfundojnë votimin.

2. Tavolina tjetër me radhë është ajo e **zyrtarit të identifikimit**. Ky rregullim i mundëson kryesuesit të punojë nga afër me zyrtarin e identifikimit, nëse është e nevojshme, që kryesuesi t'i procesojë votuesit me kusht.

3. Në tavolinën tjetër me radhë vendoseni **dhënësin e fletëvotimeve** Ajo duhet të jetë mjaft afër mbikëqyrësit të kutisë së votimit, në mënyrë që dokumenti i identifikimit, zarfi i fshehtësisë dhe zarfi i plotësuar e fletëvotimit me kusht i votuesit të mund t'i përcillet më lehtë mbikëqyrësit të kutisë së votimit. Dhënësit të fletëvotimeve i nevojitet hapësirë e duhur pune, për t'u siguruar që fletëvotimet të ruhen në gjendje të rregullt dhe larg votuesve ose personave të tjerë të paautorizuar për t'u marrë me to. Poashtu, dhënësi i fletëvotimeve duhet të ketë hapësirë për t'i spërkatur gishtërinjtë e votuesve me ngjyrë të padukshme, por pa i spërkatur edhe fletëvotimet, për ta vulosur çdo fletëvotim me vulën zyrtare të fletëvotimit dhe për të mbajtur rezerva të zarfave të fshehtësisë.

4. **Kabinat e votimit** duhet të vendosen në atë pozitë që të jenë vendi tjetër me radhë në të cilin shkon votuesi, pasi ta ketë marrë fletëvotimin nga dhënësi i fletëvotimit. Vendoseni kutinë e votimit në atë mënyrë që votuesit ta vendosin në të fletëvotimin e shënuar, para se të përzihen me votuesit që hyjnë në vendvotim. Numri i kabinave të votimit që vendosen përcaktohet nga hapësira e lirë në vendvotim. Kabinat e votimit nuk duhet të vendosen shumë afër njëra tjetrës që të rrezikohet fshehtësia e fletëvotimit. Kabinat e votimit duhet të rregullohen në atë mënyrë që pjesët e përparme të kabinave të shihen plotësisht nga këshilli i vendvotimit dhe vëzhguesit e procesit të zgjedhjeve. Mirëpo, ato duhet të vendosen në atë mënyrë që askush të mos shoh se si votuesi e shënon fletëvotimin e vet.Hapësira prapa kabinës së votimit duhet të jetë intime. Nuk duhet të shihet nga dritaret. Nëse është e nevojshme, mbuloni dritaret.

5. **Mbikëqyrësi i kutisë së votimit** duhet ta ketë një tavolinë me madhësi të mjaftueshme për ta mbajtur kutinë e votimit dhe që ofron hapësirë për t'i vendosur dokumentet e identifikimit të votuesit, zarfin e fshehtësisë dhe zarfin e plotësuar të fletëvotimit me kusht, derisa votuesi të kthehet me fletëvotim të shënuar. Edhe kutia e votimit duhet të vendoset në atë mënyrë që mbikëqyrësi i kutisë së votimit të mund të shoh se vetëm një person shkon prapa kabinës së votimit në një interval të caktuar kohor.

Vendosja e shenjave dhe njoftimeve

Njoftimet në vijim duhet të ekspozohen në vendet ku mund të vërehen më shumë dhe janë më të përshtatshme, si brenda ashtu edhe jashtë ndërtesës:

- shenjat e alfabetit të vendvotimit,
- shenjat e shigjetave për orientim,
- si të shënohen pllakatet e fletëvotimeve (MOS i vendosni brenda kabinave të votimit),
- pllakatet e kandidatëve (vendosni aty ku shihen më mirë, brenda vendvotimit),
- shenjat për ndalimin e pierjes së duhanit,
- shenjat për ndalimin e armëve.

Organizoni simulimin e votimit dhe të numërimit

Pasi të jetë rregulluar vendvotimi dhe të jenë kontrolluar të gjitha materialet, kryesuesi i këshillit të vendvotimit (dhe MNV-ja nëse ka mundësi) duhet t'i angazhojë të gjithë anëtarët e këshillit në ushtrimin e votimit dhe të numërimit. Duke i përdorur të gjitha mjetet dhe formularët e trajnimit shtohet të kuptuarit dhe besimi në procedurat e Ditës së Zgjedhjeve.

V. PËRGATITJET NË MËNGJES PARA ZGJEDHJEVE

Ky kapitull përshkruan të gjitha përgatitjet përfundimtare të hershme të zgjedhjeve të cilat duhet të kryhen deri në kohën e hapjes së vendvotimit, pra deri në orën 7.00.

Përgatitjet përfundimtare në vendvotim

Anëtarët e këshillit të vendvotimit dhe mbikëqyrësi ndërkombëtar i vendvotimit duhet të arrijnë në vendvotim deri në orën 6.00.

KKV-ja dhe MNV-ja duhet të jenë të sigurt që kabina e votimit dhe vendi ku punohet të jenë të rregulluara në atë mënyrë që ta lehtësojnë qarkullimin e rregullt të votuesve. Kryesuesi duhet të vërtetojë që secili anëtar i këshillit të vendvotimit e ka kuptuar mirë punën e vet.

MNV-ja duhet të verifikojë nëse është plotësuar fletevidentimi i punës ditore.

Rregullimi i tavolinave dhe drejtimi i qarkullimit të trafikut duhet të planifikohen një ditë më parë. Të gjitha shenjat duhet të jenë të vendosura. Nëse ka pasur vështirësi për hyrjen në vend, ose nuk ka mundur të kryhet puna, rregullimi i vendvotimit duhet të bëhet herët në mëngjes në Ditën e Zgjedhjeve, në mënyrë që votimi të fillojë në orën 7.00.

Kontrollimi i pajisjeve dhe paketimi i zarfeve

Kontrolloni përsëri inventarin e materialeve jo të ndjeshme që ju nevojiten gjatë orëve të votimit. Këtu përfshihen ditari i votimit, kabinat e votimit, zarfet e fletëvotimeve me kusht dhe zarfet e kaltëra të fshehtësisë të fletëvotimeve me kusht.

Gjeni një vend të sigurt për t'i vendosur të gjitha pajisjet dhe materialet tuaja. Kontrolloni për t'u siguruar se në listën e inventarit i keni të gjitha gjërat — si stilografët, lapsat etj. që ju nevojiten gjatë ditës.

Nëse mungojnë zarfet ose diçka tjetër e rëndësishme, njoftojeni menaxherin e qendrës së votimit. Juve do t'ju shpërndahen materialet e nevojshme. MOS u largoni nga qendra e votimit për të marrë pajisje!

Para se të votojë votuesi i parë

Para hapjes së qendrës së votimit, në praninë e plotë të vëzhguesve të procesit të zgjedhjeve, duhet të ndërmerren disa hapa. KV-ja e tregon kutinë e zbrazët të votimit para të gjithë të pranishmëve dhe pastaj me shiritat mbyllës të sigurisë e mbyll kutinë e votimit në të dyja anët. Ngjitni shiritat si duhet.Shiritat duhet të shtrëngohen mirë ashtu që pjesa e sipërme e kutisë të mbahet mirë me kutinë e votimit, pa asnjë zbrazëtirë përgjatë skajeve. Duhet të pamundësohet futja e çdo materiali përveç përmes vrimës në pjesën e sipërme.

VI. ZHVILLIMI I VOTIMIT

Orët e votimit

TË GJITHA VENDVOTIMET

HAPEN NË ORËN 7.00 DHE MBYLLEN NË ORËN 19.00

TË SHTUNËN, MË 26 TETOR 2002.

Vendvotimi duhet të hapet në orën 7.00 dhe të mbetet i hapur gjatë gjithë ditës në prani të shumicës së anëtarëve të këshillit të vendvotimit. Kjo nënkupton që pushimet dhe pauzat duhet të shfrytëzohen me radhë, pa u ndërprerë puna.

Anëtarët e këshillit të vendvotimit, të cilët duhet të votojnë në atë vendvotim, votojnë para votuesit të parë.

Përcaktimi se kush mund të votojë

Gjatë orëve të votimit, detyra e vetme më sfiduese për këshillin e vendvotimit është të përcaktohet se kush mund të votojë. Pasi të jetë marrë ky vendim për secilin person që vjen këtu, pjesët e tjera të procedurave të votimit - siç janë vulosja dhe dhënia e fletëvotimit, drejtimi i votuesit te kabina e votimit dhe të siguruarit që fletëvotimi të vendoset si duhet në kutinë e votimit - bëhen rutinë e zakonshme.

Votuesit e rregullt

Në të shumtën e rasteve, votuesit janë të përfshirë në Listën përfundimtare të votuesve në atë vendvotim që u është caktuar të votojnë. Në Listën përfundimtare të votuesve në vendvotim përfshihen emri, fotografia, data e lindjes dhe numri i regjistrimit të votuesit në Regjistrin Civil. Fotografia nuk paraqitet çdoherë.

Votuesi që paraqitet në qendrën e saktë të votimit me dokument identifikimi me fotografi të pranueshme, procesoset shpejt, edhe nëse mungon fotografia e tij në LPV.

Votuesit me kusht

Në raste të ralla, votuesit mund të mos jenë në LPV ose mund të vijnë në vendin e votimit ose qendrën e votimit që nuk u është caktuar. Ata ndoshta nuk kanë dëshirë ose nuk kanë mundur të shkojnë në qendrën e votimit që u është caktuar. Votuesit e kësaj kategorie mund të votojnë me fletëvotim me kusht nëse i përmbushin kriteret e caktuara mbi zotësinë juridike për të cilat bisedohet në faqen 33.

Votuesit me dëftesa të lëshuara përmes postës ose në Serbi, ose në Malin e Zi

Individët që jetojnë jashtë Kosovës e që do të kishin zotësi juridike për t'u përfshirë në Regjistrin Civil, përkundër mungesës së tyre, megjithatë kanë zotësi juridike për të votuar. Duke i përmbushur me sukses kriteret gjatë procesit të aplikimit, këta votues janë përfshirë në listën e votuesve të vendvotimeve që janë hapur në Serbi ose në Mal të Zi, ose në listën e votuesve që votojnë përmes postës nga shtetet e gjithë botës.

Votuesi i cili vjen në Kosovë pasi të ketë aplikuar për të votuar prej ndonjë vendi tjetër mund të votojë me fletëvotim me kusht, duke paraqitur një dokument të autorizuar identifikimi me fotografi dhe dëftesën e vlefshme të regjistrimit si votues. Në këto raste, "numri i regjistrimit" do të jetë numër nëntëshifror i regjistrimit të votuesit, e jo numër dhjetëshifror i regjistrimit civil.

Zotësia juridike për të votuar

Për të votuar personi duhet:

1. të dëshmojë identitetin e vet,
2. të jetë i regjistruar,
3. të ketë 18 vjet ose më shumë në Ditën e Zgjedhjeve.

Në të shumtën e rasteve, për t'u procesuar dhe për të votuar me **fletëvotim të rregullt,** emri i votuesit duhet të jetë në Listën përfundimtare të votuesve në atë vendvotim ku votuesi dëshiron të votojë, **dhe** votuesi duhet të paraqesë një dokument identifikimi me fotografi (dokumenti i identifikimit me fotografi nuk nevojitet nëse në të dhënat e votuesit në Listën përfundimtare të votuesve gjendet fotografia që mund të njihet).

Nëse emri i votuesit nuk mund të gjendet në Listën përfundimtare të votuesve në atë vendvotim ku ai ose ajo paraqitet, por votuesi ka një formular të pranueshëm të identifikimit, ai ose ajo mundet megjithatë të votojë, por me **fletëvotim me kusht**.

Dëshmia e identitetit

Të GJITHË personat që dëshirojnë të votojnë duhet të dëshmojnë identitetin e tyre. Ka dy mënyra për ta dëshmuar identitetin:

1. Prania e fotografisë që mund të njihet pranë emrit të personit në Listën përfundimtare të votuesve.
2. Paraqitja e dokumentit identifikues i cili përmban fotografi

PËR TË DËSHMUAR IDENTITETIN E PERSONIT MUND TË PRANOHEN DOKUMENTET VIJUESE TË IDENTIFIKIMIT ME FOTOGRAFI
Letërnjoftimi i UNMIK-ut
Letërnjoftimi i RFJ-së
Pasaporta e RFJ-së
Patentë shoferi i RFJ-së
Kartela e DI-së e lëshuar nga qeveria e huaj e njohur
Pasaporta e lëshuar nga qeveria e huaj e njohur
Patentë shoferi e lëshuar nga qeveria e huaj e njohur
Kartela e DI zyrtare e refugjatit ose dokumenti i udhëtimit i refugjatit, i lëshuar nga qeveria e huaj e njohur
Libreza e ushtrisë
Libreza/ indeksi i univerzitetit
Kartela e vlefshme e identifikimit e lëshuar nga KFOR-i, OSBE-ja ose UNMiK-u
Kartela e vlefshme e identifikimit e lëshuar nga ndonjë organizatë ndërkombëtare ndërqeveritare (duke përjashtuar organizatat joqeveritare)
Kartela e identifikimit e Shërbimit Policor të Kosovës
Dokumenti i udhëtimit i lëshuar nga UNMiK-u
Kartela e PZHBV-së e Republikës së Serbisë
Kartela e PZHBV-së e Republikës së Malit të Zi
Kartela e RFJ-së e anëtarsisë së personelit rezervë e UJ-së
Kartela e DI-së e FRJ-së e personelit të pensionuar/rezervë e APJ-së
Kartela e shëndetësisë e ushtrisë e RFJ-së
Kartela e shkollës fillore e RFJ-së (nëse ka forografi)
Kartela sanitare e RFJ-së (për personelin mjekësor)
Kartela e DI të Transportit Publik të RFJ-së
Kartela e anëtarësisë e Shoqatës së Gjuetarëve të RFJ-së
Kartela e anëtarësisë e Shoqatës së Invalidëve e RFJ-së
Kartela e anëtarësisë e Shoqatës së Vëzhguesve të Jugosllavisë

Fotokopjet e letërnjoftimit nuk pranohen!

Të dhënat mbi regjistrimin

Votuesi, emri dhe fotografia e pranueshme e të cilit janë në LPV, ka zotësi juridike për të votuar pa paraqitur asnjë dëshmi tjetër

Për votuesit që nuk janë në LPV, të dhënat mbi numrin e regjistrimit të personit (numri dhjetëshifror ose nëntëshifror) mund të merren nga një burim i përshkruar më poshtë. Ky numër u ndihmon shumë votuesve që votojnë me fletëvotim me kusht, për të konfirmuar regjistrimin dhe zotësinë juridike të tij.

Në Ditën e Zgjedhjeve, votuesit sjellin dokumente të ndryshme që përmbajnë regjistrimin e tyre. Pasqyra vijuese paraqet dokumentet që mund të dëshmojnë numrin e regjistrimit:

DOKUMENTET VIJUESE MUND TË JENË TË PRANUESHME PËR TË DËSHMUAR NUMRIN E REGJISTRIMIT TË PERSONIT
Paraqitja e letërnjoftimit të UNMiK-ut ose e dokumentit të udhëtimit që përfshin fotografinë e personit dhe numrin e regjistrimit (numri i regjistrimit të votuesit është në shpinë të letërnjoftimit dhe shënon “numrin personal”).
Kopja e konfirmimit e lëshuar nga qendra e shërbimit të votuesve për të konfirmuar votuesit caktimin e qendrës së votimit.
Paraqitja e dëftesës së regjistrimit e lëshuar në Kosovë, në Serbi ose në Mal të Zi, ose përmes opcionit me postë.
Prania e emrit të votuesit në listën e votuesve të mbarë komunës që gjendet në çdo qendër të votimit.
Kartela e caktimit të qendrës së votimit, e siguruar nga tavolina ndihmëse, në të cilën është shkruar emri dhe numri i regjistrimit të personit.

Të dhëna mbi fletëvotimet me kusht

Votuesit që votojnë me fletëvotim me kusht e hedhin votën “me kusht” që ata t’i përbmushin kërkesat mbi zotësinë juridike të votuesit dhe të mos kenë votuar më parë e as të mos tentojnë të votojnë përsëri gjatë këtyre zgjedhjeve. Të dhënat qenësore përkitazi me votuesin shkruhen në zarfin e fletëvotimit me kusht, kështu që të mund të verifikohet zotësia juridike e votuesit para se të numërohen fletëvotimet.

Fletëvotimi i shënuar i votuesit mbyllet në zarfin e fshehtësisë, i cili pastaj vendoset në zarfin e fletëvotimeve me kusht para se të vendoset në kutinë e votimit. Të dhënat mbi votuesin të shkruara mbi këtë zarf u mundësojnë zyrtarëve në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve ta konfirmojnë regjistrimin e personit dhe zotësinë juridike të tij para se të përfshihet fletëvotimi për numërim.

Gjatë procesit të verifikimit në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve, të dhënat në zarfin e fletëvotimeve me kusht verifikohen duke i krahasuar ato me bazën e të dhënave. Procesi i verifikimit për çdo aplikant që voton me fletëvotim me kusht përfshin edhe skanimin e Listës përfundimtare të votuesve për të gjitha komunat brenda Kosovës, Serbisë dhe Malit të Zi. Kjo i mundëson Qendrës së Numërimit dhe të Rezultateve të përcaktojë nëse votuesi ka hedhur më shumë se një fletëvotim.

Nëse përcaktohet se votuesi ka zotësi juridike dhe nuk ka shënime që personi tashmë ka votuar në ndonjë mënyrë tjetër, ai fletëvotim me kusht i votuesit do të numërohet.

Nëse konstatohet se personi nuk është i regjistruar në komunën përkatëse, atij i është refuzuar regjistrimi ose ka të dhëna që tregojnë se personi tashmë ka votuar, zarfi i fletëvotimit me kusht i atij votuesi mbetet i mbyllur dhe nuk përfshihet për numërim.

Bazat për refuzimin e personit për të votuar me fletëvotim të rregullt apo me kusht

- Në LPV nuk është fotografia **DHE** votuesi nuk mund të sigurojë dokument identifikimi me fotografi.
- Votuesi paraqitet në vendvotim dhe ka gjurmë të ngjyrës.
- Votuesi refuzon t'i spërkatet gishti me ngjyrën e posaçme.
- Votuesi me fletëvotim të rregullt refuzon të nënshkruajë në Listën përfundimtare të votuesve duke pranuar se ka marrë fletëvotimin.
- Votuesi me fletëvotim me kusht refuzon të nënshkruajë në Listën e votuesve me kusht duke pranuar se ka marrë fletëvotimin.
- Votuesi refuzon ta nënshkruajë deklaratën në zarfin e fletëvotimit me kusht duke pohuar se të dhënat e ofruara janë të vërteta dhe se ai ose ajo nuk ka votuar më parë dhe nuk do të votojë në asnjë mënyrë tjetër në këto zgjedhje.

Përmbledhje: Diagrami i vendimeve mbi zotësinë juridike të votuesit

Diagrami vijues ofron një pasqyrë të rregullave përkitazi me zotësinë juridike për të votuar, duke u bazuar në llojin e dokumenteve të siguruara nga votuesi dhe të dhënat që gjenden në Listën përfundimtare të votuesve. Kjo tregon nëse votuesi mund të votojë me fletëvotim të rregullt, fletëvotim me kusht apo nuk mund të votojë fare. Referohuni pasqyrave në faqet paraprake për dokumente të identifikimit me fotografi të pranueshme dhe të dhënat e numrit të regjistrimit.

Vëreni se votuesi që pohon se është regjistruar, por nuk mund të sigurojë dëshmi për numrin e regjistrimit, mund të hedhë votën. Mirëpo, nëse zotësia juridike e votuesit nuk mund të konfirmohet në bazë të informatave të tjera në zarfin e fletëvotimit me kusht, ajo votë nuk do të numërohet.

Anëtarët e këshillit të vendvotimit dhe mbikëqyrësi ndërkombëtar i vendvotimit duhet të jenë të gatshëm që t'u sqarojnë kriteret mbi zotësinë juridike votuesve që nuk janë në Listën përfundimtare të votuesve ose atyre që paraqiten pa dokumente identifikimi me fotografi.

Diagrami i vendimeve mbi zotësinë juridike të votuesit



Procesimi i votuesve

Rregulla të përgjithshme

Çdo votues duhet të votojë personalisht. Nuk lejohet të votohet në emër të personit që nuk është i pranishëm.

Çdo votues duhet të vërë shenjë në fletëvotimin e vet në fshehtësi, prapa kabinës së votimit që është siguruar për këtë qëllim. Nuk lejohet votimi me "familje" apo "në grup" dhe që prapa kabinës së votimit të ketë njëkohësisht më shumë se një person.

Pasi ta hedhë fletëvotimin, votuesi duhet të largohet nga vendvotimi dhe nuk mund të kthehet për t'u ndihmuar votuesve të tjerë.

Votuesit që kanë nevojë për ndihmë

Votuesit me aftësi të kufizuar të pamjes, analfabetët ose personat me aftësi të kufizuara mund të kërkojnë nga kryesuesi i këshillit të vendvotimit që t'ua lejojë dikë për t'u ofruar ndihmë gjatë votimit. Mbikëqyrësi ndërkombëtar i vendvotimit mund ta mbikëqyrë këtë proces.

Personi të cilin e zgjedh votuesi për t'i shërbyer si ndihmës nuk mund të jetë anëtar i këshillit të vendvotimit, as përfaqësues i akredituar i mediave, as vëzhgues i procesit të zgjedhjeve.

Personi që i ndihmon votuesit nuk është e nevojshme të jetë votues i regjistruar. Personi që ka votuar dhe i ka ndihmuar një votuesi tjetër, nuk mund të hyjë përsëri në vendvotim për t'u ndihmuar votuesve të tjerë.

Personi që i ndihmon një votuesi:

- Lejohet ta shoqërojë votuesin prapa kabinës së votimit për t'i ndihmuar votuesit të vërë shenjën në fletëvotim.
- Shënon emrin e vet të plotë dhe inicialet e veta në ditarin e votimit.
- Shënon inicialet e veta pranë emrit të votuesit në Listën përfundimtare të votuesve, ose në listën e votuesve me kusht dhe në zarfin e fletëvotimit me kusht (nëse është e zbatueshme).

Vërejtje: LPV-ja skanohet. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që inicialet e personit që i ofron ndihmë votuesit të shënohen pikërisht brenda në rubrikën e nënshkrimit të votuesit. MOS SHKRUANI MBI BARKOD OSE MBI TË DHËNAT E NDONJË VOTUESI TJETËR.

Procesimi i votuesve të rregullt

Shumica dërmuese e votuesve do të jenë në Listën përfundimtare të votuesve dhe do të kenë zotësi juridike për të votuar me fletëvotim me kusht. Procesimin e këtyre votuesve e përcjell një rutinë e vazhdueshme. (Procedurat mbi procesimin e votuesve me kusht vijojnë pas kësaj pjese në faqen 33.)

Tabelat vijuese të referencave përshkruajnë fazat që duhet t'i kalojnë një pas një kontrollori i rreshtit, zyrtari për identifikim, dhënësi i fletëvotimeve dhe vështruesi i kutisë së votimit.

FAZA 1 – KONTROLLORI I RRESHTIT (votuesit e rregullt)
Përgjegjësitë: kontrollon hyrjet në vendvotim, kontrollon ngjyrën e padukshme dhe i drejton votuesit që kanë nevojë për ndihmë.
Qëndron në hyrje të vendvotimit.
Lejon votuesit e moshuar, ata me aftësi të kufizuara ose votueset shtatëzëna të kalojnë në fillim të rreshtit.
Kontrollon reshtin në mënyrë që te dera dhe në dhomë të mos krijohet turmë me votues. Votuesit duhet të hyjnë në vendvotim një nga një.
Përcakton nëse votuesi është duke pritur në rresht të vendvotimit të saktë në kuadër të qendrës, duke u bazuar në mbiemrin e tij ose saj. Nëse jo, e drejton votuesin në vendvotimin e saktë.
Pyet votuesin nëse ka dokument identifikimi me fotografi. **Drejton** votuesit pa dokumente identifikimi te tavolina ndihmëse. Nëse një votues i tillë vjen drejtpërsëdrejti në vendvotim, i tregon votuesit se i nevojitet një dokument për ta dëshmuar identitetin e vet për të votuar me fletëvotim të rregullt dhe se zyrtari për identifikim përcakton nëse ai ose ajo mund të votojë me fletëvotim të rregullt.
Duke përdorur dritën ultraviolete, **kontrollon** gishtat e dorës së djathtë të votuesit.
Nëse votuesi refuzon t'i kontrollohen gishtat, **i tregon** votuesit se nuk mund të votojë dhe duhet të largohet nga vendvotimi.
Nëse shihni shenja të ngjyrës, **njoftojeni** votuesin se duket që ai ose ajo tashmë ka votuar dhe duhet të largohet nga vendvotimi. Kur të ndodhë një gjë e tillë, **njoftojeni** kryesuesin e këshillit të vendvotimit, kështu që ai incident të shënohet në ditarin e votimit.
Nëse nuk ka gjurmë të ngjyrës së padukshme, **drejtojeni** votuesin te zyrtari për identifikim.

FAZA 2 – ZYRTARI PËR IDENTIFIKIM (votuesit e rregullt)
Përgjegjësitë: verifikon identitetin e votuesit dhe përcakton nëse votuesi ka zotësi juridike për të votuar.
Gjen emrin e votuesit në Listën përfundimtare të votuesve duke përdorur dokumentin identifikues të votuesit.
Nëse votuesi nuk paraqet dokument identifikimi, **përcakton** nëse fotografia pranë emrit të votuesit në LPV e konfrimon identitetin e tij ose saj. Nëse po, votuesi lejohet të votojë me fletëvotim të rregullt.
Kërkon nga votuesi që të nënshkruhet ose të vërë shënjë në rubrikën e siguruar për nënshkrime. **I thotë** votuesit të mos shkruajë mbi barkodë ose mbi shënim të ndonjë votuesi tjetër.
Nëse votuesi është i paaftë të nënshkruajë në Listën përfundimtare të votuesve dhe të vërë shenjë, **shënoni** inicialet e juaja brenda në hapësirën e nënshkrimit të votuesit për të treguar se ju jeni **dëshmitar** i kësaj shenje.
Nëse votuesi refuzon të nënshkruajë ose të vërë shenjë në Listën përfundimtare të votuesve, votuesit nuk i jepet fletëvotimi. **Luteni** votuesin që të largohet bga vendvotimi.
Nëse votuesi kualifikohet për të votuar me fletëvotim të rregullt dhe ka nënshkruar në LPV, **drejtojeni** votuesin te dhënësi i fletëvotimeve.
Kjo mund të ndodhë shumë rrallë, por nëse votuesi kthehet pasi të ketë refuzuar njëherë t'i spërkatet gishti me ngjyrë të padukshme, veproni kështu: Gjeni emrin e personit në LPV. Pastaj pyeteni votuesin nëse pajtohet që gishti t'i spërkatet me ngjyrë. Dërgojeni votuesin te dhënësi i fletëvotimeve. Pasi t'i spërkatet gishti, kërkoni nga votuesi t'i shënojë inicialet e nënshkrimit të vet (mbi të cilën është vënë vijë meqë ka refuzuar t'i spërkatet ngjyra). Dërgojeni votuesin përsëri te dhënësi i fletëvotimeve për ta marrë fletëvotimin. Bëni një shënim në ditarin e votimit mbi kthimin e votuesit.

FAZA 3 – DHËNËSI I FLETËVOTIMEVE (votuesit e rregullt)
Përgjegjësitë: 1. Kujdeset për fletëvotimet e papërdorura dhe të dëmtuara 2. Spërkat me ngjyrë të padukshme gishtin tregues të dorës së djathtë të votuesit. 3. Palos, heq dhe vulos fletëvotimet. 4. Udhëzon votuesit.
Detyra 1: Ju jeni përgjegjës për mirëmbajtjen si duhet të fletëvotimeve që ju janë dorëzuar dhe për të siguruar që personat e paautorizuar të mos i prekin ato. **Hapeni** nga një pako të fletëvotimeve. Fletëvotimet duhet t'u jepen votuesve sipas rendit serik të numrave në amën e blokut të fletëvotimeve, kështu që pas përfundimit të votimit të gjitha fletëvotimet të mund të numërohen lehtë. Para se ta përdorni fletëvotimin e parë të blokut të ri, **numëroni** fletëvotimet në blok për t'u siguruar se janë 50 fletëvotime. Nëse ka më shumë ose më pak se 50 fletëvotime, **njoftojeni** KKV-në, në mënyrë që kjo parregullësi të shënohet në ditarin e votimit dhe në pjesën III të Fletës së punës së përputhjes dhe të rezultateve.
Detyra 2: Spërkateni me ngjyrë të padukshme gishtin tregues të dorës së djathtë të votuesit. **Spërkateni** pjesën e lëkurës në rrënjë të thoit. Nëse votuesi nuk e ka pjesën e thoit të gishtit tregues të dorës së djathtë, spërkateni gishtin e madh, të mesëm, të unazës ose gishtin e vogël të dorës së djathtë. Nëse votuesi nuk ka asnjë pjesë të gishtërinjve të dorës së djathtë, mund të përdoret dora e majtë duke përdorur rendin e njëjtë. Kur votuesi nuk ka asnjë gisht, hiqet dorë nga procesi i ngjyrosjes **Sigurohuni** që ngjyra të teret para se t'i jepet votuesit fletëvotimi. Nëse votuesi nuk pranon t'ia spërkatni pjesën e lëkurës në rrënjë të thoit, votuesit nuk i lejohet të votojë. **Këshillojeni** votuesin që të largohet nga vendvotimi. Në rastin e tillë, **informojeni** zyrtarin për identifikim i cili bën një shënim për këtë refuzim pranë emrit të votuesit në LPV, dhe i bie vijë nënshkrimit të votuesit. Nëse votuesi i tillë vendos të kthehet, zyrtari për identifikim do t'ju njoftojë se duhet t'ia spërkatni gishtin atij votuesi, por **MOS** ia jepni fletëvotimin. Pasi t'ia **spërkatni** gishtin, **dërgojeni** votuesin përsëri te zyrtari për identifikim, kështu që nënshkrimi të cilit i është rënë vijë të shënohet me iniciale nga votuesi. Kur zyrtari për identifikim të ju thotë se është në rregull, atëherë mund t'ia jepni fletëvotimin.
Detyra 3: Paloseni, hiqeni dhe vuloseni fletëvotimin Vulosja e fletëvotimit duhet të bëhet me kujdes të madh. Në pjesën e epërme (krye) të fletëvotimit janë të shkruara udhëzimet për votuesin. Fletëvotimi **duhet** të vuloset në pjesën e prapme të kësaj pjese të epërme, kështu që nëse bie ngjyrë mbi letër, kjo do ta njollosë vetëm pjesën e udhëzimeve. Nëse ngjyra bie mbi rreshtin e ndonjë subjekti, fletëvotimi i votuesit mund të bëhet i pavlefshëm. Për t'u siguruar që çdo fletëvotim të vuloset si duhet, është ide e mirë që përdorimi i fletëvotimeve të bëhet rutinë. Gjithmonë **palosni, hiqni** dhe **vulosni** fletëvotimet në të njëjtën mënyrë. Jepen disa sugjerime: ❑ Fletëvotimin i cili ende është i ngjitur në blokun e fletëvotimeve, **paloseni** vetëm përgjysmë kështu që fundi i letrës të bashkohet me vijën e vrimzuar. **Paloseni** fletëvotimin sërish për gjysmë (pjesa e përparme e fletëvotimit ku votuesi duhet ta shënojë zgjidhjen e vet duhet gjithmonë të paloset brenda). ❑ **Hiqeni,** griseni fletëvotimin e vetëm të palosur nga bloku, nëpër vijën me vrima. ❑ **Kthejeni prapa** fletëvotimin e palosur dhe vuloseni. Kjo do ta vendosë vulën zyrtare të

fletëvotimit në pjesën e saktë të fletëvotimit (provojeni këtë dhe do të shihni!). Shikoni si të paloset fletëvotimi, në skicën n ë faqen 32.

Nëse gjatë grisjes nga ama e blokut të fletëvotimeve, fletëvotimi prishet :

- **Shënojeni** "i dëmtuar" në pjesën e prapme të fletëvotimit dhe vendoseni në pakon e fletëvotimeve të dëmtuara (Pakoja 1)
- **Jepeni** fletëvotimin e ri duke vijuar sipas procedurave në detyrën 3.

Nëse harroni ta vulosni fletëvotimin, mbikëqyrës i kutisë së votimit (i cili e kontrollon çdo fletëvotim të votuar për të vërtetuar nëse është i vulosur) e kthen votuesin përsëri te ju. Ju duhet të shënoni "i dëmtuar" në këtë fletëvotim dhe t'i jepni një fletëvotim të ri të vulosur si duhet.

Detyra 4: Jepni udhëzime votuesit

Dorëzojani fletëvotimin e vulosur dhe të palosur votuesit dhe thuani:

- Shkoni prapa një kabine të lirë të votimit për ta shënuar fletëvotim në fshehtësi.
- Shënoni përzgjedhjen tuaj brenda rubrikës para emrit të vetëm NJË subjekti politik.
- Mos shënoni asgjë tjetër në fletëvotim, se ai mund të refuzohet gjatë numërimit.
- Pasi ta vëni shenjën në fletëvotim, paloseni njësoj dhe me vulën e dukshme zyrtare të fletëvotimit dorëzojeni te mbikëqyrësi i kutisë së votimit. Tregojani vulën, vendoseni fletëvotimin në kutinë e votimit dhe pastaj dilni nga vendvotimi.
- Nëse vëni ndonjë shenjë gabimisht në fletëvotim, mos e përmirësoni atë. Kthehuni te kjo tavolinë me fletëvotimin e palosur, me vulën e dukshme zyrtare të fletëvotimit dhe kërkoni t'ju zëvendësohet."

Nëse votuesi e dëmton fletëvotimin:

- **MOS SHIKONI** SI ËSHTË SHËNUAR FLETËVOTIMI.
- **LUTENI** VOTUESIN TA PALOSË SËRISH FLETËVOTIMIN. **Shënoni** "i dëmtuar" mbi vulën zyrtare të fletëvotimit në shpinë të fletëvotimit të palosur dhe **vendoseni** në zarfin e fletëvotimeve të dëmtuara.
- **Jepjani** votuesit një fletëvotim të ri, duke përsëritur detyrën 3 mbi dhënien e fletëvotimeve.

Çdo sqarim që jepni nuk duhet kurrë të përfshijë asnjë koment që mund të kuptohet si një qëllim për të ndikuar në përzgjedhjen e votuesit.

Si të paloset fletëvotimi

Hapi i parë: Palose fletëvotimin përgjysmëf



Hapi i dytë: Sërish palose fletëvotimin përgjysmë



Hapi i tretë: Hiqe fletëvotimin nga blloku



Hapi i katërt: Kthejeni mbrapa fletëvotimin



Hapi i pestë: Vuloseni fletëvotimin me vulën zyrtare të fletëvotimit!



FAZA 4 – MBIKËQYRËSI I KUTISË SË VOTIMIT (votuesit e rregullt)
Përgjegjësitë: 1.Ruan kutinë e votimit. 2. Kontrollon kabinat e votimit dhe siguron që vetëm një votues të votojë në të njëjtën kohë. 3. Kontrollon vulën zyrtare të fletëvotimit.
Qëndroni sa më afër kutisë së votimit, por aty prej ku mund t'i shihni mirë kabinat e votimit.
Shikoni për të siguruar që vetëm një person të shkojë prapa kabinës së votimit në të njëjtën kohë. **Thuani** personit tjetër të largohet prej kabinës së votimit.
Kontrolloni prapa kabinës së votimit. **Siguroni** që të ketë stilolaps në kabinë. Nëse ka shenja në kabinë, **mbuloni** ato me ngjitës dhe letër të bardhë.
Siguroni që askush të mos jetë në gjendje të ndërhyjë në kutinë e votimit.
Nëse votuesi nuk e ka palosur mirë fletëvotimin, **kërkoni** nga ai ta palosë si duhet. Fletëvotimi duhet të jetë i ripalosur ashtu që të mos shihet vota kurse të shihet vula zyrtare e fletëvotimit.
Nëse **vëreni** se nuk është i vulosur fletëvotimi, **thuani** votuesit të kthehet sërish te dhënësi i fletëvotimeve. Ky fletëvotim do të jetë "i dëmtuar" kurse votuesit i jepet fletëvotim i ri i vulosur si duhet. Votuesi duhet të shkojë prapa kabinës së votimit për ta shënuar fletëvotimin e ri. Përsëri, **siguroni** që fletëvotimi të jetë i palosur si duhet dhe t'i duket vula.
Siguroni që çdo votues ta ketë lëshuar fletëvotimin në kutinë e votimit para se të largohet nga vendvotimi.
Thuani votuesve të largohen nga vendvotimi pasi të votojnë. **Drejtoni** ata nga dalja.

Procesimi i votuesve me kusht

Votuesi duhet të votojë me fletëvotim me kusht nëse:

1. nuk është në Listën përfundimtare të votuesve të asaj qendre të votimit, **OSE**

2. është në Listën përfundimtare të votuesve, por pranë emrit të vet ka vulën e kuqe të fletëvotimit me kusht të votuesit (FKV).

Ka procedura shtesë që përfshihen gjatë lëshimit të fletëvotimit me kusht. Këto procedura përfshijnë shënimet e të dhënave të votuesit në listën e votuesve me fletëvotim me kusht dhe në zarfin e fletëvotimit me kusht. Për të dyja dokumentet kërkohet nënshkrimi i votuesit. Fletëvotimet me kusht NUK numërohen në vendvotim sepse, para se të përfshihen në numërim, fletëvotimet e tilla duhet t'i nënshtrohen kontrollimit të zotësisë juridike i cili kryhet në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve.

Zyrtari për identifikim përcakton nëse votuesi ka zotësi juridike për të votuar me fletëvotim me kusht duke u bazuar në dokumentin e identifikimit që e paraqet. Votuesi pa dokument identifikimi me fotografi nuk lejohet të votojë me fletëvotim me kusht (i vetmi përjashtim ndaj kësaj kërkese mund të jetë nëse të dhënat e votuesit në Listën përfundimtare të votuesve kanë fotografi që mund të njihet mirë).

Njoftojeni votuesin lidhur me zotësinë e vet juridike, duke u bazuar në udhëzimet e përshkruara në diagramet e vendimeve të zotësisë juridike në faqen 26.

Pasi që të konfirmohet nga zyrtari për identifikim zotësia juridike e votuesit për të votuar me fletëvotimin me kusht, duhet të ndërmerren disa hapa shtesë — shumica përfshijnë zarfin e fletëvotimit me kusht, që janë ilustruar në faqen tjetër. Udhëzimet në zarfet e fletëvotimeve me kusht janë të shkruara shqip, serbisht (latinicë) dhe turqisht.

Pasqyrat më faqet që vijojnë pas këtyre udhëzimeve përshkruajnë hapat e tjerë që duhet të ndërmerren nga zyrtari për identifikim, dhënësi i fletëvotimeve dhe mbikëqyrësi i kutisë së votimit gjatë procesimit të votuesve me kusht

Zarfi i fletëvotimeve me kusht



Zarfi i fletëvotimeve me kusht
Koverat za uslovni glasački listić
Şartlı oy pusulası zarfı

1. Numri me rradhë i votuesve nga lista e votuesve me kusht
Redni broj birača na uslovnom biračkom spisku
Şartlı seçmen listesindeki sıra numarası

2. Numri i vendvotimit/Broj biračkog mesta/Seçim yeri numarası

3. Numri i regjistrimit/Registarski broj/Kayıt numarası

4. Mbiemri/Prezime/Soyadı

5. Emri/Ime/Adı

6. Data e lindjes
Datum rođenja
Doğum tarihi
dita/dan/gün / muaj/mesec/ay / viti/godina/yıl

7. Unë, i nënshkruari, deklaroj se informata e mësipërme është e vërtetë dhe se më parë nuk kam votuar në asnjë mënyrë tjetër as që do të provoj të votoj përsëri në këto zgjedhje.

Ja, dole potpisani, izjavljujem da su gore navedeni podaci istiniti, i da nisam prethodno glasao ni na koji drugi način, niti ću pokušati da glasam ponovo na ovim izborima.

Ben, aşağıdaki imza sahibi, yukarıda verilen bilgilerin gerçek olduğunu ifade ediyorum ve bundan önce hiçbir şekilde oyumu kullanmadım ve bu seçimlerde tekrar hiçbir şekilde oy kullanma teşebüsünde bulunmayacağım.

Nënshkrimi i votuesit / Potpis birača / Seçmen imzası

Data / Datum / Tarih

8. A ka ofruar votuesi letërnjoftim me fotografi?
Da li je birač obezbedio ispravu sa fotografijom?
Seçmen, fotoğraflı kimlik tespit dökümanını temin etmiş mi?

po/da/evet

jo/ne/hayır

For Official Use Only
Confirmed Code
Denied Code

9. Nënshkrimi i zyrtarit të zgjedhjeve/Potpis izbornog službenika/Seçim Memurunun imzası

DEO-02-408

Udhëzime mbi zarfin e fletëvotimit me kusht

Udhëzime mbi plotësimin e zarfit të fletëvotimit me kusht
Vërejtje: Zakonisht zyrtari për identifikim e plotëson këtë zarf. Mirëpo, nëse në vendvotim krijohet turmë njerëzish, këtë mund ta bëjë edhe ndonjë zyrtar tjetër i zgjedhjeve (kryesuesi ose ndonjë punëtor i OSBE-së). Kushdo që ta plotësojë këtë zarf duhet të nënshkruhet në rreshtin 9.
Rubrika 1: Shënoni numrin treshifror të rreshtit (p.sh. 001,002 e kështu me radhë) në të cilin janë shënuar të dhënat e votuesit në LFK.
Rubrika 2: Shënoni numrin e vendvotimit tuaj. Vërejtje: kjo mund të plotësohet edhe që përpara.
Rubrika 3: Numri i regjistrimit të votuesit (numri dhjetëshifror që referohet si numër personal në shpinë të letërnjoftimit të UNMIK-ut). Nëse votuesi është regjistruar në Serbi dhe Mal të Zi, ky do të jetë numër nëntëshifror i regjistrimit të votuesit.
Rubrika 4: Shënoni mbiemrin e votuesit duke përdorur vetëm alfabetin latin.
Rubrika 5: Shënoni emrin e votuesit duke përdorur vetëm alfabetin latin.
Rubrika 6: Shënoni datën e lindjes së votuesit ashtu siç shkruan në dokumentin identifikues. Nëse votuesi nuk ka dokument identifikimi që konfirmon datën e lindjes, shënojeni datën e lindjes siç ju thotë votuesi.
Rubrika 7: Konfirmoni se votuesi e kupton se deklarata duhet të nënshkruhet në zarf. Posaçërisht, kur votuesi pohon se: • të dhënat janë të vërteta; • ai ose ajo nuk ka votuar ende, dhe • ai ose ajo nuk do të përpiqet të votojë përsëri gjatë këtyre zgjedhjeve. Luteni votuesin të nënshkruajë dhe ta shënojë datën në deklaratë. Nëse votuesi nuk mund të nënshkruajë por në hapsirën e nënshkrimit vë një shenjë, atëherë në atë hapësirë shënoni "shenja e votuesit", duke pranuar se keni qenë dëshmitar kur votuesi ka vënë shenjën.
Rubrika 8: Shënoni fjalën përkatëse **PO** ose J**O,** duke treguar nëse votuesi është identifikuar me fotografi.
Rreshti 9: Punëtori i zgjedhjeve (personeli i vendvotimit ose i OSBE-së), i cili e plotëson zarfin, duhet të nënshkruhet në hapësirën e siguruar.
MOS shkruani në rubrikën e shënuar "vetëm për përdorim zyrtar". Kjo është për përdorim të Qendrës së Numërimit dhe të Rezultateve!

Hapat shtesë që i ndërmerr zyrtari për identifikim (votuesit me kusht)
Shënon të dhënat e votuesit në rreshtin tjetër të papërdorur në **Listën e votuesve me kusht (LVK):** ❑ Përdorni dokumentet e identifikimit të votuesit për ta **shënuar** mbiemrin dhe emrin e votuesit dhe shënoni me SHKRONJA TË MËDHA TË SHTYPIT (saktësisht ashtu si shkruan në dokumente të identifikimit). ❑ Shënoni numrin e regjistrimit të votuesit. • Nëse votuesi nuk paraqet letërnjoftimin e UNMIK-ut por e din numrin e vet (nëntëshifror ose dhjetrëshifror) të regjistrimit, shënojeni atë numër në hapësirën e siguruar. Njoftojeni votuesin se nëse ky numër nuk është i saktë, kjo mund ta vështirësojë konfirmimin e verifikimit dhe se ai fletëvotim nuk mund të numërohet. • Nëse votuesi nuk e din numrin e vet të regjistrimit, tërhiqeni një vijë përgjatë kësaj hapësire dhe tregoni votuesit se nuk do t'i numërohet vota nëse ai/ajo nuk është regjistruar. ❑ **Tregoni** votuesit ku duhet të nënshkruajë në Listën e votuesve me kusht në rubrikën për nënshkrime. Nëse votuesi nuk mund të nënshkruajë, **vini inicialet** pranë shenjës së tij të identifikimit. • Nëse refuzon të nënshkruhet në Listën e votuesve me kusht, votuesi nuk lejohet të votojë dhe ai ose ajo duhet të largohet nga vendvotimi.
Plotësojeni zarfin e fletëvotimit me kusht.
Dorëzoni dokumentin identifikues të votuesit dhe zarfin e plotësuar të fletëvotimit me kusht te dhënësi i fletëvotimeve.
Drejtoni votuesit te dhënësi i fletëvotimeve.

Hapat shtesë që i ndërmerr dhënësi i fletëvotimeve (votuesit me kusht)
Pranon zarfin e plotësuar të fletëvotimit me kusht dhe dokumentin identifikues të votuesit nga zyrtari për identifikim.
Spërkat me ngjyrë të padukshme gishtin tregues të dorës së djathtë të votuesit dhe **palos, heq dhe vulos** fletëvotimin duke vijuar sipas procedurave të njëjta sikur për votuesit që votojnë me fletëvotim të rregullt.
Udhëzon votuesin si vijon: • MOS e lëshoni fletëvotimin tuaj drejtpërsëdrejti në kutinë e votimit! • Pasi të votoni, dërgojeni fletëvotimin e palosur te mbikëqyrësi i kutisë së votimit, në mënyrë që ai/ajo të shohë se është e vulosur pjesa e prapme. • Mbikëqyrësi i kutisë së votimit ju sqaron si ta mbyllni fletëvotimin në zarfin e fshehtësisë dhe në zarfin e fletëvotimit me kusht. • Pasi të përfundoni, ai (ajo) ju jep dokumentin tuaj të identifikimit.
Drejton votuesin te kabina e votimit për të votuar në fshehtësi.
Dorëzon zarfin e plotësuar të fletëvotimit me kusht, zarfin e kaltër të fshehtësisë dhe dokumentin identifikues të votuesit te mbikëqyrësi i kutisë së votimit.

Hapat shtesë që i ndërmerr mbikëqyrësi i kutisë së votimit (votuesit me kusht)
Përcillni votuesit prapa kabinave dhe **mbani në mend** dokumentin identifikues të cilit votues e mbani në dorë. **Shikoni për së afërmi** për t'u siguruar nëse votuesi me kusht nuk po e hedh fare fletëvotimin në kutinë e votimit.
Pasi të kthehet votuesi prej kabinës së votimit, **luteni** votuesin t'ju tregojë vulën në fletëvotim. **Mos e prekni** fletëvotimin. Nëse fletëvotimi duhet të ripaloset, **thuani** votuesit ta bëjë këtë në fshehtësi. Nëse fletëvotimi nuk është i vulosur, **thuani** votuesit të shkojë përsëri te dhënësi i fletëvotimeve, i cili e prish atë fletëvotim dhe i jep votuesit fletëvotim të ri. **Njoftojeni** për këtë dhënësin e fletëvotimeve. **Mbani** dokumentin identifikues të votuesit dhe zarfin e kaltër të fshehtësisë si dhe zarfin e plotësuar të fletëvotimit me kusht, derisa të kthehet votuesi me fletëvotimin e ri, të vulosur dhe të palosur.
Dorëzojani votuesit zarfin e kaltër të fshehtësisë dhe **udhëzojeni** ta mbyllë në të fletëvotimin.
Kontrollojeni DI-në për të konfirmuar se keni votuesin e saktë dhe **jepjani** votuesit zarfin e plotësuar të fletëvotimit me kusht dhe **luteni** ta vendosë në të zarfin e kaltër të fshehtësisë dhe ta mbyllë në praninë tuaj.
Udhëzojeni votuesin si ta vendosë zarfin e fletëvotimit me kusht në kutinë e votimit. Nëse ka nevojë, **ndihmoni** votuesit ta palosë zarfin e mbyllur të fletëvotimit me kusht. Por votuesi duhet ta vendosë vetë fletëvotimin në kutinë e votimit. Nëse votuesi e vendos fletëvotimin drejtpërsëdrejti në kutinë e votimit pa zarfin e fletëvotimit me kusht, **informojeni** mbikëqyrësin ndërkombëtar të vendvotimit, i cili duhet ta shënojë këtë në librin e votimit. Pastaj **luteni** votuesin ta vendosë zarfin e zbrazët të fletëvotimit me kusht në kutinë e votimit.
Kthejani dokumentin identifikues votuesit dhe **drejtojeni** votuesin të largohet nga vendvotimi.

VII. PËRFUNDIMI I VOTIMIT DHE NUMËRIMI I FLETËVOTIMEVE

Ky kapitull përshkruan procedurat për mbylljen e qendrës së votimit dhe të vendvotimit dhe numërimin dhe regjistrimin e votave. Këtu gjithashtu specifikohet se kush mund të jetë i pranishëm kur mbyllet vendvotimi dhe bëhet numërimi.

Mbikëqyrësi ndërkombëtar i vendvotimit duhet t'i mbikëqyrë gjerësisht procedurat për mbylljen e të gjitha vendvotimeve nën përgjegjësinë e vet. Duhet të merren parasysh disa faktorë për të vendosur se cilit vendvotim duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë. Kjo përfshin përvojën e mëparshme të anëtarëve të këshillit; numrin e fletëvotimeve të hedhura të rregullta dhe me kusht dhe numrin e vëzhguesve të procesit të zgjedhjeve që janë të pranishëm gjatë mbylljes.

Përfundimi i votimit

Mbyllja e qendrës së votimit

Në orën 19.00, menaxheri i qendrës së votimit e cakton një zyrtar të zgjedhjeve të qëndrojë në fund të rreshtit dhe të mos lejojë asnjë votues tjetër të hyjë në resht.

Çdo person që vjen në qendër të votimit ose në vendvotim deri në orën 19.00 duhet të lejohet të votojë. Kjo nënkupton që të gjitha vendvotimet mbeten të hapura derisa të votojnë votuesit në të gjithë rreshtat e tjerë të qendrës të votimit. Qendra e votimit mbyllet pasi të votojë votuesi i fundit.

Ku ka mundësi, mbyllet porta ose dera e qendrës së votimit për t'u paranduar personat të mos hyjnë në qendër të votimit pas orës 19.00. Personi i caktuar qëndron te dera për t'u ndihmuar votuesve të dalin nga qendra e votimit pasi të kenë votuar.

Mbyllja e vendvotimeve në kuadër të qendrës së votimit

KKV-ja e mbyll derën e vendvotimit pasi të jetë informuar që ka votuar edhe votuesi i fundit në qendrën e votimit.

Pasi të shpallet mbyllja e vendvotimit, kryesuesi menjëherë e mbyll vrimën e kutisë së votimit me një shirit ngjitës të **shkurtë** të sigurisë.

Përgatitja për numërim

Para se të hapet kutia e votimit, duhet të kryhen disa detyra.

Numërimi në vendvotim duhet të bëhet nën mbikëqyrjen e përgjithshme të MNV-së dhe të organizohet nga KKV-ja. KKV-ja u cakton detyra të posaçme anëtarëve të tjerë të këshillit të vendvotimit përkitazi me numërimin.

Gjatë përputhjes së fletëvotimeve të pranuara dhe numërimit të votave, KKV-ja cakton një anëtar tjetër të këshillit për të plotësuar pjesën e fletës së punës të Formularit të përputhjes dhe rezultateve.

Të gjitha shënimet duhet së pari të bëhen në fletën e punës. Vetëm në fund të procesit dhe kur KKV-ja dhe MNV-ja, nëse janë aty, konstatojnë se saktësia e shënimeve dhe llogaritjet janë të sakta, të dhënat prej fletës së punës transferohen në Formularin zyrtar të përputhjes dhe rezultateve.

Përgatitni hapësirën e punës për numërim

Vendvotimi duhet të rregullohet ashtu që t'ju mundësojë qasje të lehtë dhe transparente në numërimin e fletëvotimeve. Tavolinat duhet të rradhiten në atë mënyrë që anëtarët e këshillit të vendvotimit të mund të ulen gjatë procesit të numërimit dhe që vëzhguesit e procesit të zgjedhjeve të mund të lëvizin lirisht rrethit jashtë tavolinave. Shpesh më mirë funksionon kur tavolinat vendosen në formë katrore.

Me qëllim të zvogëlimit të mundësisë së shënimit me padashje të ndonjë fletëvotimi, që do ta bënte fletëvotimin të pavlefshëm, të gjithë stilolapsat, lapsat, mjetet e tjera të shkrimit ose vulat duhet të hiqen nga tavolina e numërimit. Një anëtari të këshillit të vendvotimit, që nuk i është caktuar me detyrë të merret me fletëvotimet, duhet t'i caktohet si detyrë të marrë shënimet që janë të nevojshme për të mbajtur regjistrat e llogaritjeve gjatë procesit të numërimit.

Numërimi i fletëvotimeve në kutinë e votimit

KKV-ja i pret shiritat mbyllës të plastikës në pjesët anësore të kutisë së votimit dhe i zbraz fletëvotimet mbi tavolinë. Vrima në kapak mbetet e mbyllur. Vërtetoni nëse numrat e shiritave mbyllës përputhen me numrat e shënuar në pjesën I të Formularit të përputhjes dhe rezultateve.

Të gjitha fletëvotimet duhet të shpalosen dhe të vendosen përmbys mbi tavolinë, pa shikuar si janë shënuar ballinat e fletëvotimeve.

Ndani të gjithë zarfat e fletëvotimeve me kusht nga fletëvotimet e tjera

Mos i hapni zarfat e fletëvotimeve me kusht!

Kryesuesi i këshillit të vendvotimit, apo ndonjë anëtar tjetër i caktuar i këtij këshilli, numëron zarfat e fletëvotimeve me kusht.

Të gjitha fletëvotimet me kusht vendosni në pakon 5 të fletëvotimeve me kusht dhe mbylleni. Kryesuesi i këshillit të vendvotimit duhet ta mbyllë pakon 5 dhe të nënshkruajë përgjatë kapakut të zarfit të mbyllur.

Përcaktoni numrin e fletëvotimeve të rregullta

Fletëvotimet e rregullta duhet të shpalosen një nga një dhe të vendosen **përmbys** mbi tavolinë në dengje me nga 25 copë. Çdo fletëvotim i pavulosur me vulën zyrtare të fletëvotimeve duhet të vendoset në deng të veçantë, pa shikuar në ballinën e fletëvotimit.

Kryesuesi i këshillit të vendvotimit duhet t'i caktojë anëtarët e tjerë të këshillit për ta rinumëruar çdo grumbull me nga 25 fletëvotime, për të siguruar që numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të përputhet me numërimin e parë. Nëse numrat e përgjithshëm nuk përputhen, numëroni përsëri derisa numri i njëjtë i përgjithshëm të

fitohet dy herë. **Gjatë gjithë kohës, fletëvotimet duhet të jenë përmbys mbi tavolinë.**

Mblidhni numrat e përgjithshëm të fletëvotimeve të vulosura dhe të pavulosura për të përcaktuar numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të rregullta në kutinë e votimit.

Numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të rregullta në kutinë e votimit (rubrika 14) duhet të jetë i barabartë me numrin e nënshkrimeve në Listën përfundimtare të votuesve (rubrika 10). Nëse numrat nuk përputhen, kontrolloni përsëri numrin e nënshkrimeve në LPV dhe rinumëroni fletëvotimet. Çdo ndryshim i mbetur duhet të shënohet në ditarin e vendvotimit në prani të KKV-së.

KKV-ja dhe MNV-ja, nëse janë të pranishëm, vendosin bashkarisht nëse do të përfshihen në numërim fletëvotimet që nuk janë vulosur me vulën zyrtare të fletëvotimeve.

Numërimi i votave

Largoni të gjithë stilolapsat dhe mjetet e tjera për shkrim nga tavolinat e numërimit nëse nuk i keni larguar më parë.

KKV-ja duhet të caktojë anëtarët e këshillit që u lejohet të merren me fletëvotime.

Një anëtar i këshillit të vendvotimit, që nuk është duke u marrë me fletëvotimet, duhet të caktohet që të ulet pranë tavolinës së numërimit dhe të përpilojë një "regjistër të llogaritjes" gjatë numërimit. Për shembull:

Klasifikoni fletëvotimet e rregullta

Klasifikoni fletëvotimet (përfshirë fletëvotimet e pavulosura, nëse është marrë vendim që ato të numërohen) në katër grumbuj: **të vlefshëm**, **të pavlefshëm**, **të paplotësuar,** dhe **të papërcaktuar** (nëse ka nevojë). Gjatë klasifikimit të fletëvotimeve, përmbajuni rregullave dhe shembujve të fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme të paraqitura në faqen tjetër.

Të gjitha fletëvotimet e vlefshme duhet të vendosen në njërën pjesë të tavolinës dhe të kthyera mbarë. Në këtë fazë, **MOS** krijoni grumbuj të ndarë të fletëvotimeve për asnjërin subjekt politik.



Rregullat për të përcaktuar nëse fletëvotimi është i vlefshëm, i pavlefshëm apo i paplotësuar

Fletëvotimi që është vendosur në kuti të votimit nga votuesi pa u shënuar fare do të konsiderohet "i paplotësuar".

Rregullat për të përcaktuar fletëvotimet si "të vlefshme" dhe "të pavlefshme" për këto zgjedhje janë bazuar, sa ka pasur mundësi, në parimin që me fletëvotimet të llogaritet nëse qëllimi i votuesit është i qartë. Me fjalë të tjera, çdo fletëvotim duhet të konsiderohet si i vlefshëm, perderisa nuk ka arsye të qartë dhe të fortë për ta

justifikuar refuzimin e tij. Kjo politikë bazohet në parimin themelor, sipas të cilit objekt i çdo zgjedhjeje është të vihet në dukje vullneti i shprehur i votuesit.

Duke pasur parasysh këtë, anëtarët e këshillit të vendvotimit, mbikëqyrësit ndërkombëtarë të vendvotimit dhe personeli i Qendrës së Numërimit dhe të Rezultateve duhet t'i zbatojë rregullat në vijim, për të bërë sa më shumë vota të vlefshme. Vëzhguesit e procesit të zgjedhjeve duhet të vihen në dijeni për këtë parim.

Rregullat për përcaktimin e fletëvotimeve TË VLEFSHME

Fletëvotimi konsiderohet i vlefshëm nëse qëllimi i votuesit është i qartë, dhe
Nëse fletëvotimi është shënuar me çfarëdo shenje brenda katrorit që është vendosur para emrit të vetëm një subjekti politik (shembujt: 4, 7, 8, 16, 23).
Nëse votuesi ka vënë shenjë të qartë vetëm për një subjekt politik, edhe nëse:
Shenja është vënë me ndonjë mjet tjetër shkrimi e jo me stilolapsin që lihet prapa kabinës së votuesit.
Preferenca e votuesit është treguar qartë me një shenjë (e ndryshme nga shenja brenda katrorit) para emrit të subjektit politik (shembujt: 1, 2, 3, 5, 6).
Përveç shenjës që tregon preferencën e qartë të votuesit, votuesi ka shkruar apo ka vizatuar diçka në fletëvotim (shembujt: 9, 14, 15, 17, 22).
Fletëvotimi është dëmtuar, njollosur apo ndotur, mirëpo preferenca e votuesit është e qartë (nuk është dhënë ndonjë shembull).
Fletëvotimi është grisur, mirëpo të gjithë katrorët e të gjitha subjekteve politike kanë mbetur të paprekur (shembulli: 13).
Votuesi i ka rënë vijë apo në ndonjë mënyrë tjetër ka shkarravitur mbi emrin e një apo më shumë subjekteve politike, pa vënë ndonjë shenjë që tregon votën e tij për cilëndo prej tyre, por ka bërë të qartë preferencën e vet duke vënë një shenjë të vetme për një subjekt politik, emrit të të cilit nuk i ka rënë vijë apo nuk ka shkarravitur. (shembujt: 12, 15).
Shenja "X" e vënë në katror prek katrorët tjerë, me kusht që pika qëndrore e shenjës "X" gjendet në një katror të vetëm para emrit të një subjekti politik (shembuj: 11, 16, 18).
Shenja "X" është vënë para katrorit të një subjekti politik, dhe "X" nuk e prek emrin e subjektit politik (shembulli: 24).
Pjesa më e madhe e shenjës "V" është brenda katrorit të një subjekti politik dhe as pika fillestare e pjesës më të shkurtër të shenjës veçuese, e as maja e "V" nuk dalin në ndonjë katror tjetër (shembulli: 20).
Shenja veçuese e vënë para subjektit politik prek katrorët ose emrat e subjekteve të tjera politike, por me kusht që as pika fillestare e pjesës më të shkurtër, e as pika fundore e shenjës "V" nuk kalon në ndonjë katror tjetër (shembujt: 10, 19, 21).

Valid Votes

1

19. Tottenham
20. Hotspur
21. Chelsea
22. Newcastle
23. United

2

YANINDAKI KAREYE TERCIHINIZI İŞARETLEYİNİZ.

10. Bolton Wanderers
11. Leeds United
12. Everton
13. Arsenal

3

16. Liverpool
17. Sunderland
18. Derby County
19. Tottenham
20. Hotspur

4

27. Rovers
28. Charlton
29. Athletic
30. West Ham United
31. Southampton

5

25. Fulham
26. Blackburn
27. Rovers
28. Charlton
29. Athletic

6

28. Charlton
29. Athletic
30. West Ham United
31. Southampton
32. Leicester City

7

LİSTEDEN SADECE BİR POLİTİK OLUŞUMU SEÇİNİZ VE POLİTİK OLUŞUMUN YANINDAKİ KAREYE TERCİHİNİZİ İŞARETLEYİNİZ.

10. Bolton Wanderers
11. Leeds United
12. Everton

8

31. Southampton
32. Leicester City
33. Middlesbrough
34. Madonna
35. Eric Clapton

9

26. Blackburn
27. Rovers
28. Charlton Real Madrid
29. Athletic
30. West Ham United

10

11. Leeds United
12. Everton
13. Arsenal
14. Ipswich Town
15. Man United

11

12. Everton
13. Arsenal
14. Ipswich Town
15. Man United
16. Liverpool

12

YANINDAKİ KAREYE TERCİHİNİZİ İŞARETLEYİNİZ.

11. Leeds United

Valid Votes

13

- [ ] 30. West Ham United
- [ ] 31. Southampton
- [x] 32. Leicester City
- [ ] 33. Middlesbrough
- [ ] 34. Madonna

14

- [ ] 21. Chelsea
- [ ] 22. Newcastle
- [x] 23. United
- [ ] 24. Aston Villa
- [ ] 25. Fulham

Beckham

15

LISTEDEN SADECE BİR POLİTİK OLUŞUMU SEÇİNİZ VE POLİTİK OLUŞUMUN YANINDAKİ KAREYE TERCİHİNİZİ İŞARETLEYİNİZ.

- [ ] 10. Bolton Wanderers
- [x] 11. Leeds United

ewcastle

16

- [ ] 30. West Ham United
- [ ] 31. Southampton
- [x] 32. Leicester City
- [ ] 33. Middlesbrough
- [ ] 34. Madonna

17

- [x] 21. Chelsea
- [ ] 22. Newcastle
- [ ] 23. United
- [ ] 24. Aston Villa
- [ ] 25. Fulham

18

- [ ] 11. Leeds United
- [ ] 12. Everton
- [x] 13. Arsenal
- [ ] 14. Ipswich Town
- [ ] 15. Man United

19

- [ ] 21. Chelsea
- [ ] 22. Newcastle
- [ ] 23. United
- [x] 24. Aston Villa
- [ ] 25. Fulham

20

- [ ] 21. Chelsea
- [ ] 22. Newcastle
- [x] 23. United
- [ ] 24. Aston Villa
- [ ] 25. Fulham

21

- [ ] 14. Ipswich Town
- [ ] 15. Man United
- [ ] 16. Liverpool
- [ ] 17. Sunderland
- [x] 18. Derby County

22

IZBOR U KVADRATIĆU PORED IMENA POLITIČKOG SUBJEKTA.

LİSTEDEN SADECE BİR POLİTİK OLUŞUMU SEÇİNİZ VE POLİTİK OLUŞUMUN YANINDAKİ KAREYE TERCİHİNİZİ İŞARETLEYİNİZ.

- [x] 10. Bolton Wanderers James Brown
- [ ] 11. Leeds United
- [ ] 12. Everton

23

- [ ] 10. Bolton Wanderers
- [ ] 11. Leeds United
- [ ] 12. Everton
- [ ] 13. Arsenal
- [ ] 14. Ipswich Town

24

- [ ] 23. United
- [ ] 24. Aston Villa
- [ ] 25. Fulham
- [ ] 26. Blackburn
- [ ] 27. Rovers

Rregullat për përcaktimin e fletëvotimeve TË PAVLEFSHME

FLETËVOTIMI DUHET TË SHPALLET I PAVLEFSHËM NËSE
Fletëvotimi nuk është sjellë nga OSBE-ja në formatin e autorizuar dhe nuk është lëshuar zyrtarisht në vendvotim.
Qëllimi i votuesit nuk është i qartë.
Mbi fletëvotim është shkruar, por nuk është vënë ndonjë shenjë e qartë që tregon se votuesi ka bërë zgjedhjen e vet (shembujt: 108, 111).
Shenja e votuesit është vënë mbi emrin e subjektit politik në atë mënyrë që e bën të paqartë nëse votuesi ka dashur t'i bjerë vijë emrit të ndonjë subjekti politik apo të tregojë se ka votuar për atë subjekt politik (shembujt: 109, 113, 115, 116).
Pika fillestare e anës më të shkurtër të shenjës veçuese fillon në njërin katror, por pika fundore e shenjës "V" kalon në katrorin tjetër. (shembulli: 112).
Një "X" është vënë në atë mënyrë që pika qendrore e kryqëzimit të tij gjendet ndërmjet dy katrorëve (shembulli: 105).
Votuesi ka vënë shenja që tregojnë preferencën e tij për më shumë se një subjekt politik (shembujt: 106, 110).
Votuesi ka vënë shenja që tregojnë preferencën e tij për më shumë se një subjekt politik sipas radhës së preferencës. (shembull: 107).
Fletëvotimi është grisur në atë mënyrë që janë hequr një apo më shumë katrorë që përdoren për të treguar preferencën e votuesit (shembujt: 101, 102).
Shenja që tregon preferencën e votuesit për një subjekt politik është ndryshuar, fshirë apo kryqëzuar, dhe është bërë shenjë tjetër për preferencën e tij/saj (shembujt: 103, 104, 114).
Fletëvotimi nuk është vulosur me vulën zyrtare të fletëvotimeve dhe kryesuesi i këshillit të fletëvotimeve ka vlerësuar se përfshirja e fletëvotimeve të pavulosura në numërim do të bënte që numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të rregullta në kutinë e votimit ta tejkalojë numrin e nënshkrimeve në Listën përfundimtare të votuesve.

Invalid Votes

101

17. Sunderland
18. Derby County
19. Tottenham
20. Hotspur
21. Chelsea

102

23. United
24. Aston Villa
25. Fulham
26. Blackburn
27. Rovers

103

21. Chelsea
22. Newcastle
23. United
24. Aston Villa
25. Fulham

104

14. Ipswich Town
15. Man United
16. Liverpool
17. Sunderland
18. Derby County

105

10. Bolton Wanderers
11. Leeds United
12. Everton
13. Arsenal

106

15. Man United
16. Liverpool
17. Sunderland
18. Derby County
19. Tottenham

107

31. Southampton
32. Leicester City
33. Middlesbrough
34. Madonna
35. Eric Clapton

108

14. Ipswich Town
15. Man United Beckham
16. Liverpool
17. Sunderland
18. Derby County

109

28. Charlton
29. Athletic
30. West Ham United
31. Southampton
32. Leicester City

110

22. Newcastle
23. United
24. Aston Villa
25. Fulham
26. Blackburn

111

25. Fulham
26. Blackburn
27. Rovers
28. Charlton
29. Athletic

Genesis

112

15. Man United
16. Liverpool
17. Sunderland
18. Derby County
19. Tottenham


Invalid Votes
113
15. Man United
16. Liverpool
17. Sunderland
18. Derby County
19. Tottenham
114
LİSTEDEN SADECE BİR POLİTİK OLUŞUMU SEÇİNİZ VE POLİTİK OLUŞUMUN YANINDAKİ KAREYE TERCİHİNİZİ İŞARETLEYİNİZ.
10. Bolton Wanderers
11. Leeds United
12. Everton
115
25. Fulham
26. Blackburn
27. Rovers
28. Charlton
29. Athletic
116
15. Man United
16. Liverpool
17. Sunderland
18. Derby County
19. Tottenham

Shqyrtimi i fletëvotimeve të papërcaktuara

Nëse pas përfundimit të klasifikimit fillestar ende kanë mbetur fletëvotime të papërcaktuara, duhet të ndërmerren këta hapa.

Së pari, rishikoni në tërësi shembujt e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme.

Pasi të kontrollohet çdo fletëvotim i papërcaktuar, KKV-ja shpall vendimin e tij apo të saj mbi vlefshmërinë apo pavlefshmërinë e fletëvotimit.

Pastaj fletëvotimi duhet t'i dorëzohet një anëtari tjetër të këshillit të vendvotimit, i cili e rishikon për të vërtetuar atë vendim. Ky anëtar fletëvotimin e kthyer mbarë e vendos në grumbullin përkatës të fletëvotimeve të vlefshme, të pavlefshme apo të paplotësuara.

Nëse ka ndonjë kundërshtim ndaj vendimit të kryesuesit të këshillit të vendvotimit për ndonjë fletëvotim të veçantë, vendimi mbi mënyrën e numërimit të fletëvotimit përcaktohet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të pranishëm të këshillit të vendvotimit. Në rast të votave të barabarta, kryesuesi i këshillit të vendvotimit do të marrë vendimin përfundimtar mbi mënyrën e numërimit të fletëvotimit.

Votimi i këshillit të vendvotimit nuk mund të shfrytëzohet për t'i hedhur poshtë ose për t'i ndryshuar procedurat administrative për përcaktimin e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme, siç është ilustruar në shembujt e dhënë.

Në përfundim të procesit të përcaktimit të vlefshmërisë apo të pavleshmërisë së fletëvotimeve, fletëvotimet ndahen në tre grumbuj:



Klasifikoni dhe numëroni fletëvotimet e vlefshme

Ndani mënjanë dengjet e fletëvotimeve të pavlefshme dhe të paplotësuara, aty ku mund të shihen qartë nga të gjithë anëtarët e këshillit dhe vëzhguesit e procesit të zgjedhjeve, dhe filloni t'i klasifikoni fletëvotimet e vlefshme sipas subjekteve politike.

Fletëvotimet "e vlefshme" klasifikohen në grumbuj të veçantë për secilin subjekt politik. Çdo grumbull numërohet ndaras, sipas radhës në të cilën subjektet politike figurojnë në Fletëvotim dhe në formularin e përputhjes dhe rezultateve. Pasi të jenë numëruar grumbujt e të gjitha subjekteve politike, numrat përfundimtarë të fletëvotimeve "të pavlefshme" dhe "paplotësuara" do të numërohen veçmas.

Kryesuesi i këshillit të vendvotimit ose i emëruari i tij/i saj do t'i numërojë fletëvotimet në grumbuj njërin pas tjetrin. Kryesuesi i këshillit të vendvotimit gjithashtu e cakton anëtarin tjetër të këshillit t'i rinumërojë fletëvotimet, për të konfirmuar se numri i përgjithshëm i fletëvotimeve është arritur dy herë.

Personi që është caktuar ta numërojë secilin grumbull të fletëvotimeve, gjithashtu konfirmon se fletëvotimet janë klasifikuar si duhet. Në rast se në fillim ndonjë fletëvotim nuk është vendosur në grumbullin e saktë, fletëvotimi i dhënë vendoset në grumbullin përkatës, ndërsa numri i përgjithshëm i fletëvotimeve për atë subjekt politik, i fletëvotimeve të pavlefshme ose i fletëvotimeve të paplotësuara, duhet të korrigjohet siç duhet në fletën e punës.

Gjatë kohës së numërimit të ndonjë grumbulli të fletëvotimeve, kryesuesi i këshillit të vendvotimit siguron që fletëvotimet e ndara në grumbuj të subjekteve të tjera politike, fletëvotimet e pavlefshme dhe fletëvotimet e paplotësuara, të mund të shihen plotësisht.

Kryesuesi i këshillit të vendvotimit i shpall rezultatet preliminare të përkohshme para të gjithë të pranishmëve.

Anëtarët e këshillit ose vëzhguesit e procesit të zgjedhjeve mund të kërkojnë ndonjë formular të zbrazët të rezultateve të përkohshme, për t'i shënuar rezultatet e subjekteve politike ose mund t'i shënojnë këto rezultate diku tjetër për përdorim personal. Formulari i rezultateve të përkohshme nuk duhet të nënshkruhet nga asnjë anëtar i këshillit të vendvotimit as nga mbikëqyrësi ndërkombëtar i vendvotimit.

Çdo anëtar i këshillit të vendvotimit ose çdo vëzhgues i procesit të zgjedhjeve, i cili kundërshton rezultatet e shënuara në vendvotim, mund ta shënojë mendimin e vet në librin e votimit.

Para se të veçohet Formulari i përputhjes dhe rezultateve, anëtarët e këshillit të vendvotimit dhe mbikëqyrësi ndërkombëtar i vendvotimit duhet të nënshkruajnë në rubrikat e përkatëse në fund të formularit dhe në pjesën VI.

VIII. PAKETIMI DHE TRANSPORTIMI

Në kutinë e pajimeve të vendvotimit tuaj janë disa materiale të caktuara për paketim që duhet të përdoren për klasifikim, paketim dhe transportim të materialeve të zgjedhjeve nga vendvotimi për në depo.

Paketimi korrekt ka shumë rëndësi për procesimin efikas të materialeve të vendvotimit, si në depo ashtu edhe në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve. Materialet duhet të paketohen sipas procedurave të poshtëshënuara, me qëllim që të mundësohet verifikimi, numërimi i fletëvotimeve me kusht dhe verifikimi i rezultateve - pa probleme.

Konfirmoni saktësinë e etiketave në të gjitha pakot. Pasi të jenë vënë etiketat e duhura në të gjithë thasët dhe pakot, këto materiale vendosni në pakon apo thesin e saktë. Kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme!

Pasi të mbyllen zarfet dhe thasët në përputhje me procedurat e parapara, ata duhet të grumbullohen me materialet e tjera të ndjeshme që ceken më poshtë, në tri njësi të veçanta të transportimit për t'u dërguar në depo. Njësia e katërt për transportimit nuk ka nevojë të mbyllet

KATËR NJËSITË PËR TRANSPORTIM
Materialet e ***ndjeshme*** të vendvotimit do të paketohen dhe do të mbyllen në tri njësitë për transportim si vijon:
• **Në njësinë e parë për transportim** – kutia e fletëvotimeve • **Në njësinë e dytë për transportim** – pakoja 6 (thesi i madh plastik) • **Në njësinë e tretë për transportim** – pakoja 7 (zarfi) për komisionin komunal të zgjedhjeve
Materialet ***jo të ndjeshme*** do të paketohen si vijon (nuk ka nevojë të mbyllen):
• **Në njësinë e katërt për transportim**– artikujt që mund të ripërdoren (thesi i madh plastik)

Detyrat përfundimtare

Pajisjet që duhet të lihen në qendrën e votimit

Pajisjet për zyrë dhe kabinat e votimit mund të lihen në qendër të votimit, ku mund të përdoren për nevojat e shkollës apo të shfrytëzuesve të tjerë të objektit.

ARTIKUJT QË DUHET TË LIHEN NË QENDRËN E VOTIMIT
• lapsat, stilolapsat dhe mprehësit e lapsave, • pusullat e porosive, • pakot e hapura të baterive, • qirinjtë, • letrat e ambalazhit, • kabinat e votimit.
Palosni mirë në një kuti pajisjet e zyrës së gjithë qendrës së votimit dhe nëse mundet dilni nga aty së bashku me menaxherin objektit.

Pastrojeni vendvotimin dhe qendrën e votimit

Vendvotimi duhet të lihet i pastruar dhe të gjitha mobiljet duhet të kthehen në vend të vet. Të gjitha pllakatet që kanë të bëjnë me zgjedhjet duhet të hiqen dhe të gjitha mbeturinat e grumbulluara gjatë ditës duhet të hidhen në vend të përshtatshëm. Hiqni shiritat nga dyshemeja dhe muret.

Diagrami i paketimit